



Projektbuxheti “Mbrojtja 2025”, 52,7 miliardë lekë investime, kapital njerëzor, modernizim, gatishmëri operationale



Ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu takohet me homologun e tij, Guido Crosetto në Romë

Ministri i Mbrojtjes së Shqipërisë, z. Pirro Vengu u takua në Romë, me ministrin e Mbrojtjes të Italisë, z. Guido Crosetto.

Gjatë bashkëbisedimit me homologun e tij, ministri Vengu i shprehu mirënjohjen për angazhimin e tij dhe ekipit të tij në forcimin e bashkëpunimit midis dy vendeve.

Ministri Vengu theksoi rëndësinë e partneritetit të ngushtë me Italinë, veçanërisht në kontekstin e sfidave të përbashkëta në hapësirën adriatiko-joniane dhe në vigjilencën e përbashkët për situatën e sigurisë në Ballkanin Perëndimor. Gjatë këtij takimi, dy ministrat shprehën vendosmërinë që partneriteti i natyrshëm strategjik, nën impulsin edhe të dy kryeministrave Giorgia Meloni dhe Edi Rama, të prodhojë efekte edhe në fushën e Industrisë Ushtarake.

Ministri Vengu dhe homologu i tij italian z. Guido Crosetto diskutuan ndër të tjera edhe për situatën e sigurisë dhe zhvillimet dinamike në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Angazhimet e përbashkëta operationale në kuadër të NATO-s dhe BE-së me vëmendje në misionin e KFOR-it, në Kosovë, ishin një tjetër temë e diskutimeve, ashtu si edhe zhvillimi i kapaciteteve të forcave shqiptare apo modernizimi dhe mundësitë e zhvillimit të industrisë ushtarake detare.



Studentët e vitit IV të Fakultetit të Mjekësisë së Përgjithshme, takim sensibilizues në Akademinë e Forcave të Armatosura

Në kuadër të aktiviteteve edukative dhe shëndetësore, studentët e vitit të IV të Fakultetit të Mjekësisë së Përgjithshme zhvilluan, në Akademinë e Forcave të Armatosura, një takim prezantues mbi rëndësinë e dhurimit të gjakut. Ky aktivitet u realizua në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut dhe kishte për qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për këtë akt të thjeshtë, por jetik për shpëtimin e jetëve.

Gjatë prezantimit, studentët e Fakultetit të Sigurisë dhe Mbrojtjes shprehën interes dhe u informuan mbi avantazhet e dhurimit të gjakut, si për individët, ashtu edhe për shoqërinë në përgjithësi, veçanërisht për ata që kanë nevojë urgjente për transfuzion.

Personeli mjekësor i Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut vlerësoi angazhimin dhe gatishmërinë e Forcave të Armatosura për këtë akt solidariteti human, i cili është një kontribut i thjeshtë, por me vlera të jashtëzakonshme.

Ky aktivitet ka për qëllim të inkurajojë më tej dhurimin e gjakut dhe të forcojë lidhjet mes institucioneve dhe qytetarëve.



Përfundoi stërvitja “Multinational Readiness Exercise (MNRE)”

Në zbatim të planit për stërvitjet e Forcës Tokësore për vitin 2024, një togë e Regjimentit të Këmbësisë së Jugut (RKJ) mori pjesë në stërvitjen “Multinational Readiness Exercise (MNRE)”, e cila u zhvillua në Persano, Itali.

Kjo stërvitje ishte pjesë e serisë së stërvitjeve të Grup - batalioni të Bashkimit Evropian, në të cilën morën pjesë personel nga brigada “Garibaldi”, e Forcave të Armatosura italiane si dhe personel nga Forcat e Armatosura hungareze.

Stërvitja kishte si qëllim rritjen e integritetit, ndërveprueshmërisë dhe kohezionit të forcave në nivel stafi dhe njësisht, me synim sigurimin e kapaciteteve të kombinuara për një dislokim efektiv sipas detyrave të NATO-s dhe Bashkimit Evropian.

Në këtë stërvitje efektivat e Regjimentit të Këmbësisë së Jugut kryen një sërë detyrash, sipas skenarëve të stërvitjes si: shoqërim konvoji, menaxhim refugjatësh, pika kontrolli, operatione sigurie bllokim dhe kundërsulm.

Personeli i togës së Regjimentit të Këmbësisë së Jugut përfaqësoi denjësisht FARSH-në në këtë stërvitje, duke marrë vlerësime tepër pozitive nga autoritetet drejtuese.





Projektbuxheti “Mbrojtja 2025”, do të jetë viti i dytë i plotësimit të angazhimit ndaj NATO-s, për arritjen mbi vlerën 2% në raport me Prodhimin e Brendshëm Bruto

Ministri i Mbrojtjes, z. Pirro Vengu prezantoi në një seancë dëgjimore në Komisionin Parlamentar të Sigurisë Kombëtare projektbuxhetin e vitit 2025 për Mbrojtjen. Ministri Vengu u shpreh se ky projektbuxhet është më i madhi në historinë e Mbrojtjes në dy dekadat e fundit dhe mbështet objektivin për modernizimin e Forcave të Armatosura, siguron zbatimin e reformave të iniciuara në mënyrë që investimet në Mbrojtje të përkthehen në gatishmëri operationale, dinjitet të personelit ushtarak, qëndrueshmëri të strukturave të emergjencave civile në territor dhe rritje ekonomike përmes industrializimit.

Sipas ministrit të Mbrojtjes, buxheti synon sigurimin e rritjes ekonomike përmes axhendës së industrisë ushtarake: “Viti 2025 parashikohet të jetë viti i dytë ku plotësohet detyrimi dhe angazhimi përkundërt NATO-s, për të arritur një buxhet mbi vlerën 2% në raport me Prodhimin e Brendshëm Bruto”, - tha z. Vengu.

Ministri bëri të ditur se buxheti 2025 për Ministrinë e Mbrojtjes shkon në shifrën e 52,7 miliard lekë.

Duke u ndalur te prioritetet kryesore që adreson ky buxhet, Vengu u shpreh se së pari mbështeten investimet në kapitalin njerëzor, vijimi i modernizimit dhe rritja e gatishmërisë operationale. Sipas tij, mbi 50% e investimeve janë të dedikuara në rritje kapacitetesh dhe modernizim të flotës dhe armatimit në tokë, ajër dhe det.

“Buxheti siguron vijimësinë e 21 projekteve në zbatim e sipër dhe fillimin e 8 projekteve të reja. Po ashtu, parashikohet vijimësia e 62 projekteve në infrastrukturë si dhe 8 objekte të reja që do i nënshtrohen investimit”, - tha ministri Vengu.

Ministri theksoi se parashikohet po ashtu

një buxhet i konsiderueshëm për sa i përket trajtimit financiar të efektivëve të FA-së, nga e cila përfitojnë rritje page 2500 personel të FA-së, rritje që shkon shpeshherë deri në dyfishim të rrogës.

Po ashtu, ministri i Mbrojtjes Vengu theksoi se 1 miliard lekë në buxhet shkojnë për forcën rezerviste, e cila synohet që deri në vitin 2030 të zërrë 1/5 e Forcës së Armatosur aktive.

Një mbështetje nga fondet e këtij buxheti

do të kërkohet edhe për Bazën e NATO-s në Kuçovë si dhe mirëmbajtjen e helikopterëve “Black Hawk”.

Ministri Vengu tha se synimi është që përmes Industrisë Ushtarake në vitin 2025 të fillohet gjenerimi i të ardhurave: “Buxheti parashikon ngritjen e kapaciteteve në Mjekës, Gramsh dhe Poliçan. Po ashtu synohet edhe ngritja e Agjencisë së Industrisë së Mbrojtjes”, - tha Vengu.

Sipas ministrit Vengu, Emergjencat Civile, zënë po ashtu një pjesë të konsiderueshme në buxhet me një rritje prej 300 milion lekësh.

Po ashtu, përmes këtij buxheti, ministri Vengu tha se, sigurohet financim i nevojshëm për trajnimet, edukimin dhe stërvitjet e personelit ushtarak brenda dhe jashtë vendit.

Një vend të veçantë zë edhe investimi në Kampusin e ri të Akademisë së Forcave të Armatosura.

”

“Buxheti synon sigurimin e rritjes ekonomike përmes axhendës së industrisë ushtarake. Viti 2025 parashikohet të jetë viti i dytë ku plotësohet detyrimi dhe angazhimi përkundërt NATO-s, për të arritur një buxhet mbi vlerën 2% në raport me Prodhimin e Brendshëm Bruto”.



Komanda e Forcës Ajrore vizitohet nga atashetë e shoqatës së ushtarakëve të akredituar në vendin tonë

Në kuadër të vazhdimit të një praktike disavjeçare të komunikimit dhe ndërveprimit me atashetë e huaj ushtarakë të akredituar në vendin tonë, paraditen e sotme, Shoqata e Atasheve Ushtarakë të Huaj, në bashkëpunim dhe koordinim me Drejtorinë e NATO/BE të Ministrisë së Mbrojtjes, vizitoi Komandën e Forcës Ajrore.

Në këtë vizitë grupi i atasheve u prit nga shefi i Shtabit i FAJ, N/kolonel Sulo Mustafaraj. N/kolonel Mustafaraj, e vlerësoi këtë vizitë si një aktivitet shumë të rëndësishëm për forcimin e bashkëpunimit me vendet aleate dhe partnere me strukturat e Forcave të Armatosura në përgjithësi dhe me Komandën e Forcës Ajrore në veçanti.

Më tej, grupi i atasheve, nëpërmjet një prezantimi informues, u njoh me misionin, detyrat, prioritetet dhe angazhimet kryesore të Komandës së Forcës Ajrore. Takimi vazhdoi në formatin e një bisede të lirë me pyetje dhe diskutime nga të pranishmit, në lidhje me arritjet dhe projektet më të fundit të FAJ.


Interes i veçantë, u tregua nga grupi i atasheve, për sa i përket kompletimit të Faj-së me flotën e helikopterëve “Cougar” e “Blackhawk”, dronët dhe pajisjet e kundërajrorit, si dhe bashkëpunimi që Forca Ajrore ka dhe ndërvepron me strukturat e tjera civile.



Personeli i Detashmentit UAV, përfundon me sukses trajnimin në Kesan, Turqi

Për një periudhë njëmuajore, 10 efektivë të Detashmentit të Avionëve pa Pilot (UAV) të Forcës Ajrore, zhvilluan trajnimin për përdorimin e Dronëve YIHA-X, në Qendrën e Trajnimit në Kesan, Turqi. Ky trajnim synoi rritjen e aftësive operacionale të personelit në përdorimin e teknologjive moderne të fluturimit pa pilot. Shumë shpejt këta dronë do t'i shtohen modernizimit të Forcës Ajrore, duke forcuar dhe rritur kapacitetet e saj.

Personeli i Forcës Ajrore në këtë trajnim, tregoi një performancë të lartë, kjo falë trajnimit dhe përgatitjes së lartë, që është arritur në më pak se një vit nga krijimi i Detashmentit UAV.



Përfundoi Kursi funksional Bazë në specialitetin Logjistikë/Furnizim

13 efektivë, pjesë e Komandës Mbështetëse dhe strukturave të tjera të Forcave të Armatosura përfunduan Kursin funksional Bazë të Nënoficerit në specialitetin Logjistikë/Furnizim. Në ceremoninë e certifikimit të zhvilluar në ambientet e Qendrës Stërvitore morën pjesë, komandanti i Qendrës Stërvitore, kolonel Ylli Zyla, komandantë të nënrepartëve dhe të ftuar të tjerë. Komandanti i Qendrës Stërvitore kolonel Ylli Zyla, në fjalën e tij përshëndetëse falënderoi kursantët pjesëmarrës për përkushtimin e treguar në këto 8 javë, duke vënë theksin ndër të tjera të rëndësia që kanë kurse të tilla për aftësimin e personelit në kryerjen e detyrave funksionale. Në përfundim të ceremonisë u shpërndanë certifikata dhe u realizua foto e përbashkët.



Specialistët e kompanisë EOD përfundojnë detyrën në mbështetje të personelit të Forcës së Sigurisë së Kosovës

Efektivët e kompanisë EOD në Batalionin e Xhenios përfunduan detyrën në mbështetje të qitjeve luftarake me mortaja të personelit të Forcës së Sigurisë së Kosovës të zhvilluar në rajonin stërvitor Mnelë, bashkia Shkodër.

Gjatë këtij operacioni gjashtë ditor, ekipi EOD duke përdorur procedurat dhe njohuritë e përvetësuara në bazë të Manualit ML-400-5-2, bëri vlerësimin dhe asgjësimin në vend të municioneve të paplasura tip mortaja 81 mm, duke e kthyer rajonin stërvitor Mnelë në një zonë të sigurt për zhvillimin e stërvitjeve të tjera.

Larmishmëria e operacione në të cilat angazhohen efektivët e kompanisë EOD është shumë e gjerë, duke kontribuar në sigurinë e popullsisë civile.



Nënkolonel Përparim Arriku merr detyrën e komandantit të Batalionit të Transportit

Nënkolonel Përparim Arriku, merr detyrën e komandantit të Batalionit të Transportit. Në ceremoninë e prezantimit ishin të pranishëm zëvendëskomandanti i Komandës Mbështetëse, kolonel Shkëlqim Çela, shefi i Personelit të Komandës Mbështetëse, nënkolonel Hyqmet Hoxha dhe efektivë të këtij reparti.

Në fjalën e tij përshëndetëse, zëvendëskomandanti i Komandës Mbështetëse, falënderoi efektivat e Batalionit të Transportit për punën e kryer dhe mbështetjen në çdo kohë të strukturave të Forcave të Armatosura. Gjithashtu i uroi mirëseardhjen komandantit të ri, duke shprehur besimplotë për një bashkëpunim sa më efektiv në përmbushje të misionit dhe realizimit të detyrave të këtij reparti. Komandanti i ri në detyrë, nënkolonel Arriku, u shpreh se përgjegjësia, korrektësia dhe profesionalizmi, të cilat e kanë karakterizuar në çdo hap të karrierës së tij, do të jenë udhëheqëse edhe në detyrën e re.



Prof. Asoc. Dr. BERNARD ZOTAJ

Përgatitjet për fillimin e mësymjes

Në prag të fillimit të mësymjes, u dhanë udhëzime që të viheshin në veprim të gjitha armët e rënda, si artileria, mortajat, pushkët kundërtanke e mitralozat e rëndë. Sulmi duhet të vijonte pa ndërprerje. Qëndresa që do të paraqiste armiku në objektivat e parë të sulmit nuk duhej të ndalonte përparimin e forcave tona për t’u futur në thellësi të tij. Vendet që paraqitnin qëndresë, të mbaheshin të veçuara dhe të kapeshin një nga një më pas. Gjatë natës së 10-11 nëntorit u zhvilluan veprime sulmuese në të gjithë sektorët e mësymjes, pa ndryshuar regjimin e mëparshëm të luftimeve. Kjo i hoqi mundësinë armikut që të zbulonte përgatitjet që bëheshin për fazën përfundimtare të operacionit dhe për një mësymje më të gjerë. Më 11 nëntor shtabet e brigadave, veçanërisht ai i BrVIII dhe ato të batalioneve, u njohën me terrenin dhe organizuan luftimin, ku përcaktuan: mbrojtjen e armikut, sektorët dhe drejtimet e mësymjes, rendimin e luftimit, objektet e sulmit, mënyrën e veprimit për marrjen e pikëmbështetjeve, u dhanë detyrat luftarake, u organizua bashkëveprimi etj. Të gjitha armët e rënda, si mortajat, mitralozat e rëndë, pushkët kundërtanke u vendosën në pozicione të përshtatshme. Kujdes iu kushtua organizimit të ndërlidhjes, për të cilën u caktuan nga 4 lajmëtarë, që nga kompania e lart, dhe u organizua ndërlidhja me radio ndërmjet shtabit të Divizionit dhe Korparmatës.

Fillimi i sulmit

Para se të kalohej në mësymje, 10 minuta mbi pikëmbështetjet e para të armikut u hap zjarr i dendur dhe i përqendruar me të gjitha armët e rënda. I efektshëm ishte veprimi taktik shpinëmarrës i një toge të b5p të BrIS, e cila gjatë natës së 10-11 nëntorit depërtoi në brendësi të armikut që mbrohej në ndërtesat e Maternitetit e të shtypshkronjës “Atdheu”, e sulmoi atë në befasi të plotë nga shpina dhe e kapi këtë rajon, b2p i BrIS sulmoi armikun në pikëmbështetjen te Burgu i ri, por nuk e mori dot. Pas këtij veprimi, një pjesë e forcave e mbajti të rrethuar armikun ashtu si edhe më parë, kurse pjesa tjetër përparoi në thellësi të qytetit dhe kapi ndërtesën e Radio-Tiranës. Batalionet partizane të BrIS me sulme të shpejta e të vijueshme kapën: kodrat e Fuat Beut, ndërtesat e Legatës Amerikane, krejt Pazarin e Vjetër etj. Sukses arritën edhe forcat e BrIVS, BrVIII, të cilat me krahët e brendshëm shpërthyen mbrojtjen e armikut ndërmjet kishës së Shën-Prokopit dhe kazermave “Shkumbini”. Një pjesë e forcave hynë thellë në zonën e Tiranës së Re, duke mbërritur te fusha e Shallvares (Shkolla 8-vjeçare “20 vjetori” e ndërtesat rreth saj).

Tërheqja e armikut

Në këto kushte armiku, për të mos rënë në rrethim, në kishën e Shën-Prokopit, u tërhoq. Armiku, i detyruar nga sulmet e vrullshme të forcave të tri brigadave, u tërhoq sidomos në sektorin e Tiranës së Re dhe u grumbullua në qendër të Tiranës, si në: ndërtesat e ministrive, te Sahati, hotel “Dajti”, Banka, Bashkia, hotel “Kontinental”, (hoteli “Internacional”), Shtëpia e Oficerëve. Gjithashtu ai qëndronte me këmbëngulje në kushte rrethimi në pikëmbështetjet: Burgu i Ri, Pallati Mbretëror, kazermat “Shkumbini”. Armiku në këto pikëmbështetje u mbajt i rrethuar për disa ditë, pa lidhje zjarri e taktike me forcat e tjera të tij të rrethuara në qendër të Tiranës. Komanda gjermane në këto kushte dha disa kundërsulme, me qëllim që të zgjeronte unazën e rrethimit, të mbante të hapur rrugën e Elbasanit e të rimerrte Radio-Tiranën.

Kundërsulmi i rrufeshëm i forcave partizane

Kundërsulmi i armikut dhënë më 12 nëntor nga sheshi “Skënderbej” drejt rrugës së Elbasanit nuk pati sukses, sepse b3p i BrIS e goditi atë në të dyja anët e rrugës nga Sahati e deri te Biblioteka Kombëtare (sot dega e Bibliotekës Kombëtare) dhe e detyroi të hiqte dorë nga qëllimi i tij. Kundërsulme të tjera të përsëritura dha armiku më 13 nëntor, drejt rrugës së Kavajës (rruga, “Konferenca e Pezës”) të shoqëruar me disa autoblanda, me anën e të cilave mundi të rimerrte Radio Tiranën vetëm për pak orë, sepse forcat e b2p të BrIS e b3p të BrVIII e kapën atë përfundimisht. Ndërkohë edhe njësitë e tjera të Korparmatës zhvilluan goditje të vijueshme kundër garnizoneve armike dhe autokolonave të tij në lëvizje, në të gjithë zonën e operacionit. Kjo bëri të mundur që të dështonin të gjitha përpjekjet që bënë autokolonat gjermane për tu futur në kryeqytet, sidomos nga drejtimi i rrugës Vorë-Tiranë. Forcat e BrXS, BrXXIVS dhe bp “Antonio Gramshi” nëpërmjet pritave të organizuara në rrugën Tiranë-Vorë i goditën rreptë forcat armike, gjë që çoi në dështimin e të gjitha përpjekjeve të autokolonave gjermane për t’u futur në kryeqytet. Forcat e BrXVS, pas luftimeve të ashpra, më 11 nëntor çliruan qytetin e Elbasanit.

Kështu “u çlirua Tirana me çdo kusht”



Faza përfundimtare, çlirimi i Kryeqytetit

Goditja kryesore në frontin e brendshëm jepej me krahët e brendshëm të dy brigadave (BrIVS, BrVIII) në sektorin e Tiranës së Re dhe ajo ndihmëse me një brigadë (BrIS) në Tiranën e Vjetër, kurse ndërtimi operativ përbëhej në një skalion, me rezervë një batalion.

BrIS mori detyrë të vijonte mësymjen nga vija e zënë e të asgjësonte armikun në pikëmbështetjet e tij në: Autorepart, Burgu i Ri, shtypshkronja “Atdheu” (ndërtesa “Zëri i Popullit”), Radio Tirana, hotel “Dajti”, Bashkia (sheshi para Muzeut Historik Kombëtar) e të dilte në qendër të sheshit “Skënderbej”.

BrIVS po ngushtonte frontin dhe vijonte mësymjen në vijën: Pallati Mbretëror-në të majtë të kishës së Shën Prokopit (rreth 2.5 km front), Tiranës së Re, sheshin e ministrive, ku të merrte takim me forcat e BrIS e BrVIII, b1p, që vepronte në rajonin e Qafë-Kërrabës, të godiste armikun që mund të vinte nga Elbasani.

BrIVS pasi la 1bp në Vishaj, për të ndaluar çdo depërtim të mundshëm të armikut në shpinë të forcave mësynin brenda në Tiranë.

BrVIII me 2bp të asgjësonte armikun, në radhë të parë, në kazermat “Shkumbini” dhe në fortifikatat armike në të majtë të kishës së Shën-Prokopit e deri te kazermat “Shkumbini”. Pastaj të sulmonte drejt Tiranës së Re te Banka Kombëtare, ku të takohej me BrIS e BrIVS; 2bp të mbaheshin rezervë.

BrXXIIIS vijonte goditjet kundër autokolonave, gjermane në tërheqje në rrugën Vorë-Laç.

BrXS e BrXXIVS po marshonte shpejt për të arritur sa më parë në rrugën Tiranë-Kashar-Vorë, për ta bllokuar atë dhe për

të goditur çdo forcë armike që do të qarkullonte në atë rrugë.

BrXIS dhe BrXIIS godisnin autokolonat gjermane që tërhiqeshin në rrugën Elbasan-Peqin-Kavajë, si dhe garnizonet e tij në Peqin e në Kavajë.

BrXVS vijonte goditjet kundër armikut në Elbasan e në rrugët e lëvizjes në rrethinat e tij.

BrXXS godiste autokolonat gjermane që tërhiqeshin në rrugën Librazhd-Elbasan.

BrXVIII po qëndronte në rezervë të shtabit të Korparmatës, në rajonin e Mulletit.

Artileria, me qëllim që të rritej vëllimi i zjarrit në sektorin e Tiranës së Re, ku mbrojtja e armikut ishte më e fortifikuar, bëri përqendrim të artilerisë së brigadave. Bateria e artilerisë e BrIS iu dha në përforsim BrIVS, me detyrë të bënte zjarr në pikëmbështetjet e armikut në Pallatin Mbretëror e në kishën e Shën-Prokopit. Bateria e artilerisë e BrVIII mori detyrë të bënte zjarr në pikëmbështetjen e armikut në, kazermat “Shkumbini”.

Armiku rezistoi egërsisht për tërë ditën deri natë, duke gdhirë 17 nëntori 1944, përfiton nga errësira e natës, nga depërtimi i thellë i forcave partizane dhe nga pamundësia e mbërritjes në kohë të forcave partizane që jashtë Tiranës dhe çan një rrugë tërheqje përmes Tiranës së Re, pas shpinës së forcave të BrIVS dhe BrVIII.

Në mëngjesin e 17 nëntorit 1944, pas 19 ditësh lufte epike, gjatë së cilës armiku pësoi humbje të rënda, Tirana, kryeqyteti i Shqipërisë, çlirohet. Gjatë kësaj dite reziston vetëm një grup gjermanësh në burgun e ri, por edhe ky grup asgjësohet plotësisht.

Kështu “u çlirua Tirana me çdo kusht”.



Print apo online? Historia në dilemë!

Çfarë po ndodh me tregun e printit në Shqipëri? Cilët janë “armiqtë” e vjetër dhe të rinj? Përse pothuajse çdo e përditshme ka nisur të funksionojë edhe në versionin online, si një agjenci lajmesh?

“Republika dhe shtypi i saj do të triumfojnë ose do të bien së bashku”, ka thënë Joseph Pulitzer, botues dhe themelues i çmimit të gazetarisë. Por ai dhe gjithë “baronët” e tjerë të asaj kohe në media, nuk mund ta imagjinonin se do të vinte një ditë, kur do të flitej për një tjetër lloj shtypi, për një media të re. Kjo lloj medie kërkon një model të ri ekonomik, një model të ri menaxhimi, të cilin të gjithë po përpiqen ta zbulojnë.

Shtypi i shkruar po kalon kohë të vështira. Të ardhurat janë në rënie dhe po kështu, edhe lexueshmëria. Në analizën e rënies së shtypit të shkruar, çështja kryesore nuk është cilësia, por akses.

Stili i jetës ka ndryshuar

Bankierët lexojnë. fëmijët e tyre klikojnë dhe lundrojnë në “Facebook”. Nëse dikush dëshiron të lexojë, atëherë blen një revistë ose gazetë, kush do të informohet shkon online. Media e printuar e ka bazën të shkrimit investigative, me dizajne të kuruara. Web-i përqendrohet më shumë te substanca dhe stili, por pjesa më e madhe e informacionit që del në të nuk është tërësisht i verifikuar. Kjo është fija e hollë që ndan median e vjetër nga e reja. Njerëzit navigojnë në internet për të gjetur përgjigje të shpejta për pyetjet dhe këtë e bëjnë duke kërkuar në “Google”. Ata kërkojnë informacione, si parashikimi i motit, rezultatet e ndeshjeve të futbollit etj.

Interneti i ofron të gjitha këto. Sot, ai është mik, baba, Zot dhe ekzekutor.

Pika e fortë e medias së printuar është aftësia për të kuar informacionin. Në teori, një gazetë mbledh dhe përpunon të dhënat, kalon në atë që quhet sistemi “kontrollo dhe balanco”, për të shoshitur thashethemet, të vërtetat, etj., për të strukturuar historinë, me tituj, nëntituj etj.

Web-i nuk ofron hierarki informacioni, vetëm kuti. Shpaloset vetëm ajo që është e rëndësishme. Parë në këtë këndvështrim, ai është më shumë një kolektor.

Ky është informacioni në hapësirën “cyber”, marka të besueshme po zhvillohen, por ngadalë. Sekret i mbijetesës në botën e informacionit nuk janë përmasat, por shpejtësia. Te gazetatat, lexuesit përqendrohen në fillim në çështje që kanë të bëjnë me lagjen, qytetin, vendin e më pas kalojnë tek ajo që ndodh më gjerë, në përmasa ndërkombëtare.

Kjo ndodh sepse lexuesi ndikohet më shumë nga ajo që ndodh afër tij. Gazetat janë platformat më të mira për informacione lokale. Përmasat nuk kanë rëndësi.

Sot, pyetja kryesore për shtypin e shkruar është që formatin online për lexuesit ta lënë të lirë apo me pagesë. Kjo nuk ka një përgjigje të thjeshtë.

Ka ardhur koha që media tradicionale të pranojë më në fund se web-i garanton informacionin e shpejtë, ndërsa printi thellësi. Të dyja mediat janë plotësuese dhe jo konkurruese. Rruga që përshkoi është e përbashkët.

Në rënie të lirë

Sipas monitorimeve të “MC Monitoring”, për muajt e parë të këtij viti reklamat në median e shkruar u ulën rreth 17% në krahasim me një vit më parë. Kjo tendencë parashikohet të vazhdojë.

Prej vitesh, tregu i mbipopulluar i gazetave (numërohen rreth 20 gazeta për 1,000 banorë) pritej që të riformatohej, por edhe pse pati disa mbyllje titujsh, përsëri u hapën të reja. Tani, gjendja duket se është rënduar më shumë, pavarësisht se ka edhe përjashtime. Pak kohë më parë, një nga gazetatat e rëndësishme në treg, ndërmori disa



WEB-I NUK OFRON HIERARKI INFORMACIONI, VETËM KUTI. SHPALOSET VETËM AJO QË ËSHTË E RËNDËSISHME. PARË NË KËTË KËNDVËSHTRIM, AI ËSHTË MË SHUMË NJË KOLEKTOR. KY ËSHTË INFORMACIONI NË HAPËSIRËN “CYBER”, MARKA TË BESUESHME PO ZHVILLOHEN, POR NGADALË. SEKRETI I MBIJETESËS NË BOTËN E INFORMACIONIT NUK JANË PËRMASAT, POR SHPEJTËSIA. TE GAZETAT, LEXUESIT PËRQENDROHEN NË FILLIM NË ÇËSHTJE QË KANË TË BËJNË ME LAGJEN, QYTETIN, VENDIN E MË PAS KALOJNË TEK AJO QË NDODH MË GJERË, NË PËRMASA NDËRKOMBËTARE.

ndryshime që kryesisht kishin të bënin me reduktimin e shpenzimeve. Kryeredaktori i saj thotë se kjo ndodhi për shkak të ndryshimit të shitjes së gazetës dhe shkurtimit të faqeve. “Gjatë periudhës së fundit njëmuajore, falë këtyre masave dhe ristrukturimit të redaksisë, tirazhi është rritur me mbi 45%. Ne dhe gjithë gazetatat e tjera e dimë shumë mirë se në shtypin e shkruar ka vështirësi, se ekziston një krizë e përgjithshme në mbarë botën për gazetatat në variantin e tyre print.

Në Shqipëri lexohet shumë pak. Statistikat tregojnë se në treg ekzistojnë rreth 20 tituj për 1,000 banorë, një ndër raportet më të ulëta në botë, i ngjashëm me vende si Tunizia, Algjeria e Indonezia.

Rekord për lexueshmëri mban Norvegjia dhe Hungaria, me rreth 500 gazeta për 1,000 banorë.

Në Shqipëri, raporti rritet kryesisht në fundjavë, kur gazetatat e përditshme dalin me suplemente apo hidhen në treg titujt e radhës të gazetave që trajtojnë thashetheme nga bota e personazheve të njohura.

Nga viti në vit, gazetatat kanë ulur edhe tirazhet. Drejtuesit e

shtypshkronjave thonë se raporti mes shitjes dhe kthimit (pas botimit) është kthyer në nivelin e mëparshëm 70% me 30%.

Problem shqetësues që vazhdon të mbartet nga viti në vit për median e printuar është edhe shpërndarja. Në zonat rurale pothuajse mungon shtypi i shkruar, edhe në qendrat kryesore urbane ky zinxhir nuk funksionon, ose nuk është efikas. Drejtuesit e medias së shkruar thonë se është e rëndësishme që të rivlerësohet gjendja e shtypit të shkruar, të ndërhyhet në sistemin e shpërndarjes, në rritjen e çmimit të shitjes për njësi dhe në orientimin më të madh të reklamës drejt shtypit të shkruar.

Interneti, a është një “armik”?!

Biznesi i mediave online vazhdon të jetë i fokusuar te reklama, tek lajmet e rreme (fake news), apo ato në formatin thashetheme. Penetrimi i internetit nuk është aq i madh në Shqipëri sa rrezikoi ndjeshëm shtypin e shkruar.

Ende as 10% e 700,000 familjeve nuk kanë internet. “Gazetat print kanë një treg më vete. Problemi është se media, në rastin e



Shqipërisë, ia ka ngushtuar tregun vetes dhe punon për një rreth shumë të kufizuar njerëzish, që kanë interes për lajme politike. Faqet online në Shqipëri kanë më shumë vizita nga jashtë vendit se sa nga brenda vendit. Në tërësi nuk është shumë e vlefshme të përdoret logjika ekonomike për të shpjeguar shtypin shqiptar, qoftë atë të printuar, qoftë atë online. “Media në internet është shumë e lirë për ta ndërtuar, mund të kushtojë jo më shumë se 500 dollarë për një faqe. Platformat e ndërtimit të faqeve të lajmeve si “Joomla” apo “Worldpress” janë zhvilluar shumë dhe mund të

përdoren nga të gjithë. Lehtësia në ndërtimin e platformës e publikimit të lajmeve nuk është e mjaftueshme për sukses, shumica dërrmuese e faqeve të internetit nuk kanë prodhim të vetin. Më së shumti jetojnë duke vjedhur lajmet që prodhojnë të tjerët. Në këtë kontekst, besohet se nuk e kanë jetën të gjatë, pavarësisht suksesit të imagjinuar. “Vjedhja e informacioneve në internet është toleruar deri më sot nga media konvencionale, për shkak se nuk ka ende një volum reklamash të konsiderueshëm në rrjet sa për të pasur interes për

ndalimin e vjedhjeve. Por në rastin që reklamuesit i rrisin fondet për reklama, atëherë shumë nga faqet që sot renditen si më të vizituarat nga shqiptarët, do të përballen me padi për numrin e pafundmë të lajmeve që kanë ripublikuar pa të drejtë autori.

Për lexuesit, konkurrenca në print është reale

Ajo fillon nga prodhimi i lajmeve spekulative dhe përfundon të rrjetet e shpërndarjes e te gazetashitësit. Në internet, konkurrenca konsiston më së shumti në spekulime të vogla me motorët e kërkimit, fjalët kyçe të përdorura, apo sasia e lajmeve të vjedhura nga të tjerët. Për tregun e reklamave, gazetatat e printuara kanë rol të pazëvendësueshëm në publikimin e njoftimeve për vende pune, tenderë etj., të cilat, ndonëse mund të publikohen edhe në internet, kanë nevojë për vlerën e printit si dokument.

Sa për reklamat në internet, vetë reklamuesit shpesh nuk kanë kapacitetet e nevojshme analizuese për të parë efektivitetin e një reklame, pra kemi më shumë reklama miopike.

Kriza e medias së printuar në Shqipëri nuk lidhet aq shumë me zhvillimin e internetit se sa me rënien e sektorit të ndërtimit, nga ku varej shumica e medias. Rrjetet sociale kanë sjellë normalisht një konkurrencë reale për median konvencionale, pasi njerëzit kanë një alternativë, nuk e kanë të domosdoshme të lexojnë një gazetë, për të kaluar kohën apo për t’u informuar. Në total, në Shqipëri qarkullojnë jo më shumë se pesë apo shtatë lajme në ditë, të lidhura vetëm me politikën dhe me kronikën e zezë.

Janë këto lajme që qarkullojnë në të gjitha televizionet, gazetatat apo faqet e internetit. Ndërkohë lexuesit kanë mundësi të zgjedhin dhe mund ta harxhojnë kohën e tyre për të vizituar profilin e një miku të vet në “Facebook”, të shohin se si ka dalë në fotografi e se kush ka ndryshuar foton e profilit. Kjo hapje tregu do t’i detyrojë mediat konvencionale të prodhojnë lajme reale, të cilat i kemi parë shumë rrallë gjatë dekadës së fundit.

Çfarë do të ndodhë? Kush do ta fitojë “garën”?

A do të jetë shtypi i shkruar apo media e re?

Është çështje shijesh dhe kohe. Unë dua të besoj se magjia e një lajmi në letër e tipografisë nuk ka të krahasuar me atë të një lajmi të klikuar online.

Gazetat do të vazhdojnë të jetojnë, sigurisht koha do të largojë ato që nuk do t’i mbijetojnë një gare me rregulla, e cila ende nuk ekziston në Shqipëri.

E njëjta gjë vlen edhe për faqet online. Do të jetojnë ato që do të dinë të ruajnë dhe të zgjerojnë numrin e lexuesve.

Njerëzit e duan gazetën. Duan të lexojnë në letër atë çka shkruhet. Kjo fazë transitore do të kalojë shumë shpejt, sepse koha do të bëjë edhe selektimin e atyre gazetave që nuk i rezistojnë dot zhvillimit të medias.

Ajo që i mbetet e gjallë historisë është shkronja e zezë mbi letër e bardhë e faqosur dhe printuar, koha mund t’i zbehë ngjyrën letrës por kurrë nuk mund të fshijë vlerën historike të ngjarjes shkruar mbi të.

“

KONKURRENCA KONSISTON MË SË SHUMTI NË SPEKULIME TË VOGLA ME MOTORËT E KËRKIMIT, FJALËT KYÇE TË PËRDORURA, APO SASIA E LAJMEVE TË VJEDHURA NGA TË TJERËT. PËR TREGUN E REKLAMAVE, GAZETAT E PRINTUARA KANË ROL TË PAZËVENDËSUESHËM NË PUBLIKIMIN E NJOFTIMEVE PËR VENDE PUNE, TENDERË ETJ., TË CILAT, NDONËSE MUND TË PUBLIKOHEN EDHE NË INTERNET, KANË NEVOJË PËR VLERËN E PRINTIT SI DOKUMENT.



75 VITE ART, BOTIME, SHTYP PERIODIK

Rrugëtimi në dekada i QKMBMMFA

Shtëpia e Usharakëve është e lidhur ngushtësisht me ndryshimet dhe zhvillimin e Forcave të Armatosura. Ajo nisi rrugëtimin e saj në një ndërtesë krejt të veçantë në Rrugën e Kavajës, e projektuar dhe e zbatuar nga inxhinieri i Armës së Xhenios të Ushtrisë Mbretërore Shqiptare, major Dhimitër Dhespoti.

Shefi i parë i “Shtëpisë së Oficerëve ishte kapiteni i Klasit I, Fehmi Poshi, oficer intendenca i Komandës së Mbrojtjes Kombëtare.

Pas lirimit në të njëjtën ndërtesë, më 14 nëntor 1947, u përurua “Shtëpia Qendrore e Ushtrisë Kombëtare Shqiptare”. Ajo, së bashku me hotel “Internacional”, që shërbente për ngrënien e fjetjen e oficerëve beqarë, lulishten në qendër dhe me sallën 300 vendesh e kinoteatrit dhe më pas “Estradës së Ushtarit” (1952), përbënin një kompleks të plotë shërbimesh për kohën, për të gjithë ushtarakët e Ushtrisë Kombëtare Shqiptare.

Pararendës i strukturës së “Shtëpisë Qendrore” ishte seksioni i Artit, në të cilin bënte pjesë Kori i Ushtrisë, Banda Frymore dhe Teatri, të cilët kishin kohë që kishin filluar aktivitetin e tyre artistik, e më pas seksioni për “Shkollat dhe arsimimin”, seksioni i “Prapavijës”, Klubi Sportiv “Partizani” dhe Laboratori Fotografik. Kjo organikë e miratuar përbëhej nga rreth 130 veta, numër ky që herë-herë rritej, sepse në korin e ushtrisë përfshiheshin edhe ushtarë të shërbimit të detyrueshëm ushtarak.

Pjesë e misionit të këtij institucioni, për gati një dekadë rresht, krahas gjallërimit të jetës artistike në Ushtrinë Shqiptare nga grupet artistike, ishte edhe dhënia e ndihmës së domosdoshme, të kualifikuar e konkrete nga të gjithë sektorët kundër analfabetizmit, që gati mbretëronte në radhët e Ushtrisë Shqiptare, si dhe arsimimi, kulturimi e mësimi i gjuhëve të huaja nga ana e oficerëve të sapo dalë nga lufta.

I vetmi grup artistik i këtyre viteve, “Kori i Ushtrisë”, jepte koncerte e shfaqje jo vetëm në “Shtëpinë e Oficerëve”, por edhe kinematë qytetëse “Kosova” e “Nacional”, duke plotësuar kërkesat e shumta nga i gjithë populli i Tiranës, për të arritur në koncertin kulmues me këngë partizane, patriotike e popullore dhe në fund me “Castativën” e kënduar nga Tefta Tashko Koço.

Turnetë artistike vijuan edhe në aksionet e rinisë, në rrugën Kukës-Peshkopi, hekurudhën Durrës-Tiranë, në kantierin e tharjes së kënetës në Maliq, në kanalin “Naum Panxhi”, por edhe në qytetin e Ohrit e më pas në atë të Shkupit, për shqiptarët me banim në këto qytete së bashku me Grupin e Valleve (’47).

Banda e Ushtrisë, përveç se ishte një aset i çmuar, në krijimtarinë dhe ekzekutimin e muzikës shqiptare, ishte prezente në koncertet e saj, në ceremoni e manifestime të panumërta, në përkujtimin



e ngjarjeve historike kryesore, në parada apo edhe në pritjet protokollare të Shtetit Shqiptar. Kjo trupë artistike profesioniste u kthye në furnizuese e të gjitha institucioneve të tjera artistike shtetërore.

Klubi Sportiv “Partizani”, pjesë e “Shtëpisë Qendrore të Ushtrisë Kombëtare Shqiptare” dha një ndihmesë të rëndësishme në organizimin dhe zhvillimin e lëvizjes fizikulturore e sportive në

Garnizonin e Tiranës dhe në reparte të tjera të Ushtrisë Shqiptare.

Laboratori Fotografik, si pjesë e propagandës figurative me vlera dokumentare artistike dhe edukuese për ushtrinë, filloi menjëherë aktivitetin me pasion e këmbëngulje, duke grumbulluar negativët e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe të jetës partizane, duke hedhur themelet e fondit arkivor.

Në dhjetor të vitit 1949, “Shtëpia Qendrore e Ushtrisë Kombëtare Shqiptare” përbëhej nga Ansambli i Këngëve dhe i Valles, Kori e Grupi i valleve; Seksioni i muzikës, Banda e Orkestra Simfonike; Teatri, Kinemaja, Seksioni i Arsimimit, Biblioteka, Seksioni i Fizikulturës, skuadra e futbollit, basketbollit, volejbollit, atletikës së lehtë dhe të rëndë, shahu, noti e motoçiklizmi; Seksioni i shërbimeve, e në përmbyllje e plotësonte ai i ushqimit social, pra Bufeja, e cila nga viti 1968, nuk u bë pjesë e kësaj strukture. E gjithë kjo strukturë përbëhej nga një efektiv prej 253 vetash, të cilët 13 ishin oficerë dhe 240 nëpunës civilë.

Tërësia e trupave, artistike, sportive, qendrat lëvizëse të agjitacionit në reparte e njësitë, por edhe në stërvitjet e mëdha me trupa për kohën, shtypi, shfaqjet e filmave kinematografikë, propaganda figurative dhe botimet albumeve e fletëpalosjeve, të përgatitura nga “Shtëpia Qendrore e Ushtrisë Popullore” (SHQUP), luajtën rol të rëndësishëm në edukimin ideo-artistik e sportiv, jo vetëm për repartet e garnizonit të Tiranës, të Ushtrisë Shqiptare, por edhe në skenat e ambientet, ku qytetarë të shumtë ndiqnin aktivitetet, në kushtet e realitetit shqiptar të kohës.

Nga kjo punë me strukturë komplekse, për nga funksionet që kryente, e organizuar dhe intensive në radhët e të rinjve, që kryenin e përfundonin shërbimet ushtarake, dolën mjaft artistë, këngëtarë, kompozitorë të shquar dhe sportistë të talentuar, në sferat e ndryshme të jetës e të mjeshhtërisë fizikulturore e sportive.

Në vitet ‘50-’60 të shek. XX, pati ndryshime të ndjeshme në organikat e SHQUP-it, në vitin 1958 u suprimua Teatri i Ushtrisë e një vit më pas, Klubi Sportiv “Partizani”, Ansambli i Ushtrisë dhe Banda e Ushtrisë u shkëputën nga ky institucion, për t’u rikthyer përsëri, këto dy të fundit në vitin 1966.

Në vitet 1962-1964, SHQUP-i u vendos në godinën e korpusit parlamentar të Akademisë së Shkencave, të cilat shërbyen për zhvillimin e veprimtarive të shumta të organizuara nga ky institucion. Në këto ambiente ndodhej edhe Biblioteka me rreth 20.000 tituj librash. Më pas SHQUP-i u vendos përkohësisht në ambientet ku sot është Banka Kombëtare Shqiptare dhe si sallë për koncerte shërbeu godina që ndodhej mbas Komandës së Gardës.


Në vitet ‘60, në SHQUP ndërvepronin Sektori Metodik, i Kulturës, i Propagandës, i Krijimtarisë, Biblioteka dhe Dega e Mbështetjes.

Në tërësi këta sektorë kanë luajtur një rol të rëndësishëm në zbatimin e misionit që përçonte ky institucion nëpërmjet formave





të ndryshme, për t'i bërë sa më efektive krijimtaritë në sferën e gjerë të propagandës, ndihmës metodike nëpër reparte, diafilmat me pamje nga stërvitjet e ndryshme, gatishmërisë, jetës ushtarake, përgjithësimet e përvojës së përparuar me botimet që prodhonte SHQUP-i etj. Një vend të rëndësishëm zinte organizimi nga drejtuesit e edukimit, të vizitave e të ekskursioneve në fshatrat ku bëhej kolektivizimi, në aksionet ku ndërtoheshin hekurudhat, në hidrocentrale, takimet me shkrimtarë të ndryshëm, por edhe me të dalluarit në ushtri.



Më 10 korrik 1968, u përrua godina e re pranë Urës së Lanës, tek rruga e Elbasanit, në të cilën u vendosën dy drejtori ndërvepruese, SHQUP-i në katin e dytë dhe në katin e parë Drejtoria e Ushqimit Social, që në zhargonin përditshëm njihej “Restoranti i SHQUP-it”.

Në këtë qendër të re ndodheshin dy salla, njëra me 204 vende uljeje dhe skenë dhe tjetra me 50 vende, holli kryesor për vendosje ekspozitash tipologjike, si dhe për organizimin e homazheve për ushtarakë dhe personalitete të tjerë shtetërorë. “Shtëpia Qendrore e Oficerëve” mbante peshën kryesore të aktiviteteve të natyrave të ndryshme në shkallë ushtrie por edhe për aktivitetet e argëtimit me familjet dhe fëmijët e ushtarakëve, sidomos ditëve të shtuna, të diela dhe ditët festive.

Vitet ‘70-’80, u shoqëruan me ndryshime strukturore të SHQUP-it, u suprimua sektori i krijimtarisë dhe sektori i prodhimit kinematografik, krijuar në vitin 1976, i cili iu kalua Kinostudios “Shqipëria e Re”, u formua sektori metodik, u bënë spastrime e seleksionime në fondin e bibliotekës.

Në këtë periudhë, me rastin e përvjetorëve të shumtë të festave të ndryshme historike, aktivitetet e Orkestrës Frymore, Ansambllit të Ushtrisë, dhe Estradës së Ushtarit ishin të shumta. Krahës tyre SHQUP-i organizonte shpërndarjen e shtypit, aktivitete kulturore, artistike, shfaqje filmash me pjesëmarrësit e paradave, stimuj moral, propagandimi i të dalluarve, fletëpalosje të ndryshme, shfaqje të përbashkëta me institucionet artistike të Shtetit, të cilat rezultuan

në 100 koncerte e shfaqje artistike, disa ekspozita fotografike, 60 shfaqje kinematografike në njësitë e repartet e Ushtrisë.

SHQUP-i organizoi edhe festivalin e filmit me tematikë për mbrojtjen, ekspozita fotografike me tematika: “Për mbrojtjen”, emisione muziko-letrare e artistike, ligjërata “Pasqyrimi i mbrojtjes së atdheut në letërsinë artistike”, diskutime krijuese “Aktivitetet kulturore-artistike dhe lidhja e tyre me jetën, stërvitjen, disiplinën dhe gatishmërinë në Ushtrinë Shqiptare”, etj.

Gjatë vitit 1985, trupat artistike u shkëputën nga drejtimi i SHQUP-it dhe formuan komandë më vete dhe pas dy vitesh edhe Shkolla e Lirë Ushtarake e Kinostudios “Shqipëria e Re”, me përjashtim të Komandës së Batalionit Artistik, që vijoi të qëndronte në vartësi të SHQUP-it.

Trupat artistike të SHQUP-it, Ansambli i Ushtrisë, Orkestra Frymore dhe Estrada e Ushtrisë, si shkolla të para profesioniste të artit shqiptar, kryen një veprimtari të gjatë artistike në 50 vite (1944-1994), duke dhënë 6000 koncerte, si brenda dhe jashtë Shqipërisë, ndërsa Sektori i prodhimit kinematografik, 1967-1974, prodhoi rreth 50 filma dokumentarë ushtarakë, propagandistikë dhe mësimorë.

Që nga viti i krijimit të SHQUP-it e në vijimësi, ndryshimet që ajo ka pësuar në strukturën e saj, janë të lidhura ngushtë me domosdoshmërinë e realizimit sa më të mirë të misionit të këtij institucionit. Struktura organizative dhe organika që ka patur kjo Pasuri e Rëndësishme Kombëtare, mesatarisht ndër vite ka rezultuar me një personel prej rreth 200 vetash.

Reformave

të shumta në Forcat e Armatosura, në vitet ‘90 e më pas, përfshinë institucionin e Shtëpisë Qendrore të Ushtrisë, e cila qysh në fillim, me rikonceptimin e misionit të saj, pësoi ndryshime jo vetëm në riemërtimet e saj të herëpashershme por u shoqëruan edhe me shkurtime në strukturë e personel. Ndërkohë u rivendosën gradat ushtarake, u hoq funksioni i komisarit politik dhe i sekretarit të partisë dhe u vendos ligji i depolitizimit dhe i departizimit të institucionit.

Pas kalimit në “Qendër të Kulturës të Ushtrisë” (‘92), u rikonceptua “Ansambli i Ushtrisë” dhe “Estrada e Ushtarit” (‘93), e në vend të tyre u ringrit Grupi artistik, që së bashku me Orkestrën Frymore të Ushtrisë, vijuan aktivitetet e tyre nëpër repartet e ndryshme të Ushtrisë Shqiptare, por edhe në stërvitjet e përbashkëta të zhvilluara në kuadrin e Marrëveshjes për Partneritetin për Paqe, koncerte për forcat shumëkombëshe që erdhën



në Shqipëri në 1997 etj.

Në përbërje të këtij institucioni (administrata, biblioteka, grupi artistik, orkestra frymore: 86 veta) u përfshi edhe Qendra e Foto-Filmit të Ushtrisë (‘97), e cila u fuqizua me aparatura televizive (‘93), duke prodhuar rreth 20 filma dokumentarë dhe një numër të madh kronikash televizive, duke konkurruar edhe në Festivalin Ndërkombëtar të filmit ushtarak në Rumani, i vlerësuar me “Çmim Special”.

Në dekadën e parë të “Shekullit të Ri”, të përgatitjes dhe futjes në NATO, Institucioni, tashmë me emrin “Qendra e Kulturës, Medias dhe Botimeve të Mbrojtjes”, ashtu si dhe FASH-i pësuan ndryshime thelbësore, qysh nga misioni i saj, i cili përcaktonte: “Informimi i qytetarëve dhe efektivave të Forcave të Armatosura të RSH-së, mbi aktivitetin që zhvillojnë këto forca, operacionet e tyre në kohë paqe, në konflikt apo luftë, edukimi i efektivave të FA-së e ndjenjat e patriotizmit, virtytet qytetare dhe vlerat e lirisë e demokracisë”.

Bashkëpunimi e përafrimi me Strukturat e NATO-s ndikuan edhe në riorganizimin e “Qendrës së Kulturës, Medias dhe Botimeve të Mbrojtjes”, i cili u ngrit në nivel drejtorie, si: Marrëdhënie me Publikun dhe informim, Drejtoria e Publikimeve, Drejtoria e Aktiviteteve dhe Marrëdhënieve me Komunitetin, Drejtoria e Aktiviteteve Sportive, që rrokjin rreth 129 veta.

Me kalimin në strukturën e re organizative dhe vendosjen në planin e përhapjes së FARSH-së (2014), ky institucion me urdhër nr. 615, datë 23.07.2014, mori emërtimin “Qendra e Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes; Muzeu dhe Shtëpitë e Pushimit të Ushtarakëve”, me përbërje: Drejtoria e Kulturës, Medias dhe Botimeve, Drejtoria e administratës dhe shërbimeve, Muzeu i FA-së dhe Shtëpitë e Pushimit të Ushtarakëve, me personel rreth 157 veta.

Mbështetur në urdhrin nr.1217, dt.09.10.2016, ky institucion u emërtua “Qendra e Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes, Muzeut të FA-së”, i cili vijon aktivitetin për realizimin e misionit të saj.





KAPITEN (P) VERI TALUSHLLARI

Djemtë oficerë të Zerecit, historia e ndritur e fshatit juglindor

Dielli i buzëqesh në mëngjes në Gurshqipe dhe largohet në Çukën e Korbit. I gjithë fshati mbetet rrethuar në mbretërinë e lartësive të Qafës së Gjarprit, Gurit të prerë, Malit Koshnicë, që shekuj të tërë nuk i janë trembur dhe gjunjëzuar erozioneve të kohës dhe historisë, as nga bora dimërore dhe as nga gjësimet e predhave të pushtuesit që ka lënë gjurmë dhe këtyre anëve.

Zereci ynë i dashur ka nxjerrë burra e gra të pushkës e të punës, të dijes dhe të kulturës. E po t'i referohemi shkrimtarit tonë të njohur Skënder Demolli, i cili e njih mirë Oparin, Zereci e ka pasur traditë të qenit luftëtar, më parë se bujk e blegtor, si fshat me origjinë kalorësish të Skënderbeut, që e dëshmon edhe rezidenca princërore e Muzakajve në Bungë, vend i mbrojtur nga të gjitha anët, siç e dëshmojnë edhe emrat e toponimeve apo lagjeve të fshatit, p.sh. Kalarët-kalororët-kalorësit etj. Por siç e dëshmon edhe ndjenja e fortë e atdhetarisë, me kontributin e madh në Luftën NÇ.

Ishte një djalë i këtij fshati që, në vjeshtë të vitit 1942, krijoi një nga çetat e para, bëhet fjalë për një nga 3-4 çetat e para partizane, në radhët e së cilës ishin 18 djem të atij fshati që Shaban Marjanakun, Shaban Zereci, siç njihet e ndoqën në shtigjet e Luftës. E prej tyre ishte Dëshmori i Atdheut Kajmak Murati që dha jetën e tij të re në rrugën Korçë - Pogradec në luftë me fashistët.

Të tjerët pas Luftës iu kthyen punës, disa në fshat, disa të tjerë u rreshtuan në radhët e Ushtrisë Popullore. Vetë Shabani, me gjithë çka ndodhur në jetën e tij të dhimbshme, punoi si oficer. Nga ata që erdhën nga Lufta, për shkak të nivelit arsimor dhe reformave të thella që u bënë në ato vite në radhët e Forcave të Armatosura, u punësuan në sektorë të tjerë të jetës shoqërore.

Por djemtë dhe më pas nipërit e tyre shërbyen e shërbejnë me krenari në radhët Ushtrisë. Çlirimi është djali i Shabanit, para meje në foto është xhaxhai im Ilmiu dhe babai im Hajriu, Adriatiku është nipi i Avniut, Pëllumbi është djali i Qerimit, e kështu me radhë.

Këtu më duhet të kërkoj falje, pasi nga që nuk kisha njohuritë e sakta, kam lënë pa përmendur Shuaip Lamin, Novruz e Gëzim Marjanakun, veçanërisht ky i fundit ka një karrierë të gjatë në njësitë ushtarake të zonës së Maliqit.

E nëse do të kisha përmendur edhe nënoficerët, disa prej të cilëve janë pensionuar si të tillë, si Lulëzimi, Figani, Refati... lista do të ishte shumë e gjatë.

E për ta mbyllur, jam krenar të flas për dy djem të rinj që janë të shkolluar në Akademitë Ushtarake brenda e jashtë vendit me programet bashkëkohore të NATO-s. Flas për Fabion dhe Luftarin, djemtë e vëllait të Dëshmorit të Atdheut Çelnik Talushllari, të cilëve u urojmë të çojnë më tej një traditë të bukur e krenare në misionin që kanë ndaj Nderit, Detyrës, Atdheut; siç bënë paraardhësit tanë: Shaban Marjanaku, Çelnik Talushllari, Kasëm Isallari, Fuat Hoxha, Qerim Kiciasi, Avni Marjanaku, Ilmi Talushllari, Isuf Kalari, Ali Merdani, Hajri Talushllari, Hysen Koçiasi, Nebi Koçiasi, Çlirim Marjanaku, Fluturim Koçiasi, Adriatik Marjanaku, Luan Talushllari, Vladimir Koçiasi, Veri Talushllari, Fabio Talushllari, Luftar Talushllari.



ADRIATIK MARJANAKU

*Zereci është një ndër
fshatrat me histori të
lashtë dhe me pozitën
gjeografike më të bukur
në njësinë administra-
tive Moglicë, pjesë e rre-
thit të Korçës. Rruga që
gjarpëron herë majtas
dhe herë djathtas lumit
Devoll është tërheqëse,
duke çlodhur shikimin në
relievin natyror, Fshati
shtrihet në jugperëndim të
qytezës së Moglicës.*

Autori: Maurizio Nocera
Përshtati në shqip: Elidiana Canaj,
Docente Dr. në Sociologji

Të nderuar veteranë të LANÇ-it, të Popullit Shqiptar, miq dhe shokë shqiptarë!

Italia është vendi im që, padyshim, e dua shumë, por edhe Shqipëria, njerëzit e saj të mrekullueshëm, të cilët i njoh që në moshë të re, janë pjesë e rëndësishme e ndjenjave të mia më të dashura. Ngjarja që vijon është një faqe e historisë ushtarake dhe gjeopolitike pothuajse krejtësisht e panjohur për italianët. E propozoj edhe këtu si kujtim e mesazh për brezat e rinj që një ditë do të duan të dinë më shumë. Nuk e di nëse akademikët e shkencës në Shqipëri e njohin librin e Alfonso Bartolini-t (Romë, 1914-2001), oficer dhe partizan i karrierës Bersagliere (Medalje Argjendi në V.M.) së pari në Greqi (në radhët e E.L.A.S.), pastaj në kufirin greko-shqiptar. Bartolini ishte sekretar kombëtar i Shoqatës Kombëtare të Partizanëve të Italisë (ANPI) nga viti 1946 deri në vitin 2001, si edhe ka qenë themelues dhe drejtor i revistës “Patria Indipendente”.

Titulli i librit është “Historia e Rezistencës Italiane jashtë vendit” (Rebellato editore, Padova 1965, fq. 476). Në të ka një kapitull – “Brigada ‘Gramshi’, njësia ‘Garibaldi’”, fq. 249-261 – ku flet për batalionin “Antonio Gramshi”, duke raportuar disa ngjarje ushtarake që nuk gjenden në shkrime të tjera. Duke pasur parasysh datën e botimit të librit (1965), Bartolini, padyshim, e shkruan historinë e tij pa e ditur se çfarë ndodhi në Shqipëri pas atij viti. Për shembull, ai nuk shkruan se Komandanti Suprem i të gjithë Rezistencës antinaziste-antifashiste shqiptare ishte komandanti Enver Hoxha. Por, pavarësisht kësaj, pjesa tjetër e historisë së tij shkon po aq mirë sa vaji i derdhur në një fetë bukë të pjekur mirë. Ajo që më intereson këtu janë disa të dhëna thelbësore për të kuptuar se cili ka qenë kontributi i italianëve, disa prej tyre nga Salento dhe Leçe, në luftën partizane në Shqipëri.

Fakti i parë, që lidhet me themelimin (10 tetor 1943) e batalionit “Gramshi” është se ai u komandua menjëherë nga rreshteri toskan Terisilio Cardinali (Terranova Bracciolini, 25 korrik 1913 - Strelsa-Albania, 8 korrik 1944), që iu akordua Medalja e Artë. Themelimi i batalionit u pasua nga 170 ushtarë të tjerë. Ky ishte një departament i Rezistencës Italo-Shqiptare që mbeti i skalitur në kujtesën e atyre që ishin pjesë e saj. Gjatë periudhës së themelimit të tij pati dy beteja themelore: e para, në mbrojtjen e Beratit, më 15 nëntor 1943, ku batalioni u shkatërrua në përleshjen me nazistët dhe ballistët (Balli Kombëtar, nacionalistë fashistë shqiptarë), nga 170 vetëm 48 mbetën gjallë, ngjarja e dytë ndodhi në Çerenec - të Gjoricës (Bulqizë, rrethi i Dibrës, Shqipëri), më 8 korrik 1944, ku Cardinali u vra në një përplasje të ashpër me nazistët dhe ballistët.

Ai ishte gati të hidhte një granatë dore kur një breshëri e zjarrit me automatik nazist e goditi atë. Komandantët e zgjedhur përkrah Kardinalit ishin: Kompania e parë, komandanti Remo Cerneluti, komisar politik Romeo Cicerchia; Kompania e dytë, komandanti Giuseppe Monti, komisar politik Francesco Baracchi; Kompania e tretë, komandanti Giovan Battista Cavallotto, komisar politik Bruno Brunetti; Komisar politik i të gjithë batalionit ishte Leo Dal Ponte, i vrarë në betejën e Beratit.



Bartolini shkruan:

“Batalioni, pas vdekjes së Kardinalit, nuk kishte kohë as të rindërtonte komandën e tij, nga ana tjetër, të tria kompanitë duhej të vepronin veçmas në atë kohë. Vetëm në shtator (1943), gjatë një pauze të shkurtër, batalioni mundi të vazhdonte dhe të riorganizonte komandën e tij. (Komisari politik Alfredo D’Angelo; kryeintendent Ermanno Vasari, Kompania e parë, komandanti Ilio Carrai, komisar politik Oliviero Bonaventura, Kompania e dytë, komandanti Angelo Gatto (i cili u plagos) dhe u zëvendësua nga Giuseppe Monti, komisar Bruno Brunetti, Kompania e tretë, komandanti Giovan Battista Cavallotto, komisar Loreto Millucci. Drejtues i shërbimit shëndetësor, dr. Pier Francesco delle Sedie). “Gramshi” rifillon menjëherë marshimin, nga njëri skaj i Shqipërisë në tjetrin, duke mbuluar një rreth që shtërngohej gjithnjë e më shumë rreth Tiranës, ku batalioni spikati në aksione të shumta luftarake, të cilat u zhvilluan gjatë 10 muajve të parë të vitit 1944. Më 17 nëntor të po atij viti, rezistenca e fundit naziste u asgjësua në sheshin Skënderbej dhe Tirana u çlirua përfundimisht. Mbi 2000 ushtarë partizanë italianë qëndruan përkrah partizanëve shqiptarë për çlirimin e plotë të vendit. Batalioni “Gramshi” u bë fillimisht Brigadë dhe më pas Divizion gjithmonë me të njëjtin emër, atë “Antonio Gramshi” (Antonio Sebastiano Francesco Gramshi. Ales, 22 janar 1891 – Romë, 27 prill 1937, me origjinë shqiptare). Stërgjyshi mbërriti me familjen në Itali në fillim të shekullit të 19-të. Antonio Gramshi së bashku me Giacomo Matteottin ishin martirët e parë të fashizmit, të vrarë direkt me

Batalioni “Gramshi”, ushtarët italianë në luftën antinaziste - antifashiste në Shqipëri



urdhër të Musolinit.

Për ne, Salentosit, konkretisht për ne Leçesët, na pëlqen të kujtojmë batalionin “Gramshi”, mbi të gjitha sepse brenda tij, ishte edhe vajza Leçe (e lindur në Avellino, por e martuar me një djalë nga Lecce) Annunziata Fiore, e cila ishte e mitur, 13 vjeç, e sapo operuar kur mori pushkën dhe ndoqi partizanët në mal.

Bartolini shkruan: “Një fakt është i sigurt, nga Durrësi dhe Tirana, pas Çlirimit të vendit, nga autoritetet (shqiptare) u riatdhësuan rreth 19.000 italianë, nga të cilët 447 të plagosur rëndë dhe të sëmurë, që u transportuan me rrugë ajrore”. Një tjetër e dhënë (burimi Mario Palermo, ministër italian i luftës) na thotë se 2000 luftëtarë partizanë ishin pjesë e njërive italiane,10.000 ushtarë të shpërndarë në të gjithë vendin në repartet shqiptare dhe në zonat malore të kontrolluara nga komandat partizane, 8000 civilë. Bartolini bën të ditur gjithashtu se, pas Çlirimit, në Tiranë u themelua Klubi “Garibaldi”, i cili botoi një revistë javore të titulluar “Bashkimi” dhe, njëherësh shërbeu për t’u marrë me një sërë detyrash suplementare (procedurat e riatdhësimit në Itali e kështu me radhë).

Bartolini shkruan sërish: “Batalioni ‘Antonio Gramshi’ kishte karakterizimin e tij politik të theksuar që e bëri atë shprehjen më të avancuar të antifashizmit që kishte shpërthyer mes ushtarëve italianë. Vetë emri Gramshi, që kishte marrë njësia ushtarake, ishte një simbol që përfaqësonte një lidhje si me antifashizmin militant italian, ashtu edhe me karakterin e shquar komunist të qeverisë nacionalçlirimtare shqiptare. Karakteri i theksuar politik i kësaj njësie ushtarake nuk shprehej aq shumë në kuadrot ushtarake të tërësi - kishte një numër të madh të nënoficerëve të ushtrisë - por, sidomos, nëpërmjet komisarëve politikë të zgjedhur rrigorizisht. Do të ishte gabim të mendohej se komandat shqiptare ushtronin diskriminim të veçantë ndaj italianëve që mbetën të luftonin me ta. Vetëm Batalioni “Gramshi” kishte një karakterizim politik më të theksuar, që shprehej, mbi të gjitha, në konferenca dhe takime, që kishin si temë tema politike dhe ushtarake, me synimin për të ndjekur, ndihmuar dhe kuptuar e ilustruar situatën e përgjithshme brenda kuadrit të zhvillimeve së luftës për përmbysjen e nazizmit”. Një tjetër partizan që shkroi për Batalionin “Antonio Gramshi” ishte Enzo Misefari (Palizzi, 1899 – Reggio Calabria, 1993), sindikalist, antifashist, socialist dhe komunist (për disa vite në PCD’l m-l, Partia Komuniste e Italisë, Marksist-Leninist), parti në të cilën ishte sekretar i përgjithshëm partizani Fosco Dinucci. Misefari, në librin “Rezistenca e shqiptarëve kundër imperializmit fashist” (Edizioni di Cultura Popolare, Milano, 1976, i kushton një kapitull Batalionit “Antonio Gramshi”, ku shkruan: “Forca e batalionit në fillim ishte vetëm 320 burra të pajisur me pak armë kolektive (mitraloz e mortaja) dhe pak armë individuale (mitralozë) etj. - shumë më të nevojshme për luftën guerile partizane. Filloi luftimet në fillim të tetorit duke sulmuar kolonat e blinduara gjermane, kryesisht në rrugën e Elbasanit dhe të Tiranës, duke i shkakuar armikut humbje të konsiderueshme”.

Luftëtarët e batalionit “A. Gramshi”, nën komandën e Kardinalit në krye të batalionit, nisën sulmin duke u përplasur me gjermanët dhe xhandarët (të Ballit Kombëtar) në luftimet e zhvilluara në fshatin Çerenec të Gjoricës - Bulqizë në rrethin e Dibrës. Pak metra larg pozicioneve të armikut, Tercilio Cardinali, teksa do të hidhte një granatë dore, u godit nga një breshëri automatiku i armikut dhe u rrëzua përtokë.

Ai arriti të shqiptojë vetëm fjalët: “Vazhdoni sulmin! Unë po vdes, por jam i lumtur. Unë vdes për idealin. Rroftë Partia Komuniste Shqiptare”. Misefari boton edhe Apelin e komandantit Enver Hoxha drejtuar partizanëve italianë, të njohur nga shumëkush prej jush, ndaj nuk po e citoj këtu!

Nga Ditari “Associazione Casa della Resistenza, Verbania Fondotoce, 2012”, i Battista Cavallotto, komandant i Kompanisë së 3-të të batalionit “Antonio Gramshi”, po marr vetëm një pasazh, që ka të bëjë me një mik dhe shoqërues timin shqiptar, që e kam takuar prej vitesh në tokën shqiptare: “Në muajin maj të vitit 1943, komanda e brigadës së parë vendosi të dërgonte në formacionin tonë një partizan shqiptar që fliste shumë mirë gjuhën tonë. Kjo ishte një zgjidhje e nevojshme edhe për të mos u marrë drejtpërdrejt me shqiptarë të tjerë. Quhej SAMI KOTHERIA, vinte nga Elbasani dhe ishte student universiteti. Gjatë periudhës partizane ai pati fatin e keq se humbi babanë dhe një vëlla, që u vranë nga repartet reaksionare. Nuk mund të kishte ardhur mes nesh një shok më i mirë se Samiu. Ai ishte si një vëlla për ne. Gjithmonë ishte i gatshëm për të na ndihmuar në çdo gjë që kishim nevojë. Prania e

tij e mirëpritur na u la deri në fund të luftës, fundi i nëntorit 1944, pas së cilës ai u kthye në Brigadën Shqiptare. Më vonë mësova se ishte diplomuar për letërsi dhe e ushtronte profesionin në shkollat e mesme të Tiranës. Ai ishte martuar me një vajzë italiane nga Trieste dhe kishte shumë fëmijë. Që nga mbarimi i luftës, ose më mirë që nga riatdhësimi, kam qenë gjithmonë në korrespondencë me të dhe, nëpërmjet tij, merrja lajme nga Shqipëria, që unë e konsideroj si atdheun tim të dytë”. Sami Kotheria ishte gjithmonë udhërrëfyesi im shqiptar sidomos në vitet 1973-1990, kur isha anëtar i Këshillit Kombëtar të Shoqatës Itali-Shqipëri dhe për këtë arsye, çdo vit, në verë, drejtoja grupet e miqve të Shqipërisë në Tokën e Shqiponjave. Nuk e kam harruar kurrë dhe sot, që jam këtu për të kujtuar Batalionin “Gramshi”, e nderoj.

Në Kompaninë III të Batalionit “Gramshi”, të komanduar nga Battista Cavallotto, ishin partizanët Spenga Antonio (nga Lecce) dhe Vito De Lorenzis (nga Dragoni-Lequile i Leçes). Cavallotto shkruan përsëri: “Të gjithë italianët, që ishin shpërndarë nëpër fshatra të ndryshme, u dyndën drejt Tiranës, kryeqytetit të Shqipërisë dhe qendrës së të gjitha rrugëve të komunikimit, për të punuar për familjet e fermerëve shqiptarë. Nga oficerët dhe civilët italianë u themelua një klub i quajtur “Garibaldi”, i cili kishte funksionet e një lokali çlodhës dhe një klubi argëtimi. Në krye të saj u vu gjeneral Piccini i Firences dhe, me ndihmën edhe të oficerëve të tjerë, po ashtu të shpërndarë nëpër fshatra të ndryshëm, u përpoqën t’u jepnin një ndihmë të vogël atyre që kishin më shumë nevojë. Prej tyre mësuam se Gjeneral Azzi, nga Cuneo, komandant i Divizionit të Firences dhe major Chiarizia, shef i Shtabit të të njëjtit formacion, në qershor të po atij viti - 1944, kishin hipur në një nëndetëse angleze afër Vlorës dhe u kthyen në Itali, nga ku ndihmuan dërgimin e ndihmave, nëpërmjet nisjeve aleate, për italianët që mbetën në vend. Ne tek “Gramshi”, me sa di, kemi pasur gjithmonë jo shumë luftëtarë, të cilët kanë luftuar me armë kundër nazistëve gjermanë dhe kundër forcave të Ballit Kombëtar. Në fillim të vitit 1943, shkova në Tiranë me detyrën për të pyetur nëse midis italianëve që kishin mbërritur atje nga shoqëruesit apo nga formacionet e tjera partizane shqiptare, kishte ndonjë person që dëshironte të bashkohej me “Antonio Gramshin”. Kam gjetur shumë prej tyre, të cilët, pas një deklarate me shkrim nga ana ime, kanë kërkuar të vazhdojnë drejt selisë në Milot.

Para riatdhësimit tonë, komandanti i përgjithshëm, gjeneral Enver Hoxha na dërgoi një mesazh. Mesazhi i Enver Hoxhës për partizanët italianë është i njohur, ndaj nuk po e përsëris këtu. Por historia më e plotë e Batalionit, e Brigadës dhe e Divizionit “Antonio Gramshi” gjendet në librin “Liri Popullit”. “Partizanët italianë në Shqipëri” - Një shembull i internacionalizmit proletar (Cultura Cooperativa Editrice, Firenze, 1974, botim i redaktuar nga një grup studimor i Rrethit Firenze të Shoqatës Itali-Shqipëri, i përbërë nga partizanët Bruno Brunetti (kryetar i Rrethit) dhe Enzo Busi dhe nga miqtë Alessandro Carrasco, Roberto Renzoni, Daniela Ricci dhe Sergio Staino.

Dedikimi në faqen e parë të librit është i rëndësishëm, “Shokëve të luftës për lirinë e popullit,/ popullit shqiptar/ që me besim të madh në Partinë e Punës/ i zgjati duart ushtarëve të tyre pushtues për t’i ndihmuar edhe pse ende të plagosur nga tirania nazifashiste/ Shpetoi emrin e Italisë/ dhe na mësoi rrugën drejt një shoqërie më të drejtë. Unë po bëj vetëm një shënim tek Parathënia: “Shqipëria është një shembull në të cilin Rezistenca fitoi deri në pasojat e fundit kundër pushtimit të jashtëm dhe kundër reagimit të brendshëm: një shembull në të cilin objektivi i çlirimit kombëtar është i lidhur ngushtë me emancipimin e klasave popullore. Faqet që përshkruajnë jetën në batalionin “Antonio Gramshi” dhe marrëdhëniet me popullsinë janë plot mësim: vepimtaria e komisarëve politikë, konferencat e batalionit, kritika dhe autokritika, solidariteti mes shokëve etj. Këto marrëdhënie të reja njerëzore shpesh dalin nga shkrimet e tij me një sinqeritet prekës. Nga ana tjetër, ashpërsia me të cilën goditen gabimet dhe vendimet e nxituara. Pikërisht në kontrastin midis demokracisë maksimale dhe zbatimit të ngurtë të së njëjtës, qëndron forca e përvojës partizane në Shqipëri, arsyeja e fitores së saj - mësim për brezat e rinj”. Libri përmban emrat e mijëra ushtarëve italianë që u bënë partizanë dhe luftuan për lirinë e popullit shqiptar nga nazifashizmi. Shumë prej tyre ranë në fushën e betejës. Ky shkrim i kushtohet sakrificës së tyre.

Një shënim anësor, por, që në të vërtetë nuk është një shënim anësor.

Kur, në mars të vitit 1991, populli shqiptar me nxitjen e fuqive të huaja (SHBA, Britania e Madhe, Vatikani, Evropa e Bashkuar etj.) dhe me nxitjen e nazifashistëve të vjetër e të rinj shqiptarë (Balli Kombëtar më shumë pinjollë të regjimeve reaksionare) vendosën të ndryshojnë sistemin socialist të Republikës Popullore të Shqipërisë, unë kisha vendosur të mos shkelja më kurrë në tokën shqiptare. Megjithatë, në vitin 1997 ndodhi një ngjarje, që më ndryshoi mendjen. Partizanja Nexhmije Hoxha, pasi kishte kaluar më shumë se gjashtë vjet burg të padrejtë për ofrimin e kafesë si një motër e Terezës së Kalkutës, u lirua, edhe me kontributin e një fushate ndërkombëtare për lirinim e saj. Që nga ai vit u ktheva në tokën që e doja dhe e dua, dhe gjithmonë (pothuajse çdo vit) isha mysafir i kësaj partizaneje të mrekullueshme. Ajo që më ka mësuar Nexhmija, ka një rëndësi të madhe për mua dhe nuk do të mund ta harroj kurrë. Kur më foli për batalionin “Gramshi” sytë, tashmë të moshuar, u ndezën përsëri, duke më thënë: “Faleminderit edhe ju italianëve, që Shqipëria arriti të çlirohej nga nazifashizmi ndër vendet e para të Europës”.



"E vetmja mënyrë për të bërë punë të mëdha është që ta doni atë që bëni"

Steve Jobs,
manjati i famshëm i Apple



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

“Puna është art, arti do kulturë”

“Kultura e administratës”, përmbledh normat, parimet, vlerat personale, formimin akademik, dhe jo vetëm, të personelit të saj. Çdo njeri është vetvetiu i provokuar me mendimin se nuk mund t’iu mësosh të tjerëve atë që nuk e ke mësuar vetë. Nuk ka dyshim se metodat e këqija, edhe “mësimin e mirë” e bëjnë të keq. Mësimi mund të krahasohet me “lumin që s’ndalet”.

I madhi Platon ka thënë: “Shteti është i përbërë nga individët dhe është e nevojshme që virtytet të arrihen nga çdo person, që nga zejtari që duhet të ketë virtytin e urtësisë e deri te drejtuesit që kanë përgjegjësinë që t’i afrohen njohjes të së mirës”. Për Platonin, shteti ideal ishte aristokracia, ku mbizotëronte arsyeja racionale. Sot nuk e di nëse është realitet apo utopi e ardhur nga “mesjeta e mençur”.

Shteti shqiptar edhe pse i ka kaluar të njëqind vjetët e krijimit të tij, në përbërjet e tij të administratës publike ka marrë shumë pak nga qeverisjet e mëparshme, përfshi periudhën e Ismail Qemalit, atë të gjashtë mujorit të Princ Vidit, të regjimit gjysmë republikë dhe gjysmë monarki të Ahmet Zogut dhe atij të sistemit komunist. Si dhe sa ka ndikuar kjo në ditët e sotme?

Formulime për etikën dhe kulturën e punës në administratën shqiptare e gjejmë edhe në periudhën e qeverisjes së Zogut

Në një qarkore që selia e Kryeministrit u dërgonte dikastereve, Drejtorive të Përgjithshme dhe bashkive mbi sjelljen e nëpunësve, ndër të tjera thuhej: “ma së pari duhet vazhdimi rregullisht i nëpunësve në detyrë, punimi i tyre me zell e me energji të plotë e thjeshtë Kombëtar, ashtu dhe sjellja e atyne me ç’do njeri, si në zyrë q’i bie rasti për çdo një punë zyrtare, si edhe jashtë, të jetë e urtë, e njerëzishme e plot me nderë...”.

Në periudhën e shtetit të diktaturës së proletarietit, etika e aplikuar ishte ajo e ideologjisë komuniste, nuk kishte rregulla të shkruara apo Kod Etike, por njerëzit ndiqnin atë që bënin paraardhësit e tyre në punë dhe vepronin duke zbatuar një autocensurë të fuqishme.

Sa e domosdoshme dhe e rëndësishme është kultura e komunikimit në administratë?

Ndryshe nga shumë shoqëri të tjera, fqinje apo më gjerë, vendi ynë nuk ka ndonjë traditë në ndërtimin e administratës publike

dhe aq më pak në kulturën e komunikimit dhe etikën që duhet ta përshkojë atë. Megjithëse një ngrehinë shtetërore mbi 100-vjeçare, qeverisja e Ismail Qemalit, administrata e Ahmet Zogut dhe e ajo shtetit totalitar, nuk arritën të krijonin një model që mund të ndiqej nga brezat pasardhëse.

Vendi i punës është një nga vendet më të rëndësishme në jetën tonë. Ne shpenzojmë pothuajse 1/3 për gjysmën e jetës sonë në vendin e punës. Duke pasur parasysh këtë fakt, respektimi i parimeve etike e bën këtë vend më të bukur, më harmonik dhe të favorshëm për rritjen personale dhe rritjen e organizatës. Pra ne shpenzojmë një sasi të madhe kohe në ambientin e punës, atmosfera është e rëndësishme, pasi ka një ndikim të drejtpërdrejtë në shëndetin tonë.

Çdo vend pune pa parimet bazë të etikës jo vetëm që nuk mund të jetë në harmoni por ka dhe mungesë në produktivitet. Kjo nuk është e dëmshme vetëm për vendin e punës por dhe për vetë organizatën, pasi zvogëlon efikasitetin e saj. Ndaj, vendosja e parimeve të rëndësishme etike rrit produktivitetin dhe efikasitetin në vendin e punës.

A duhen formuluar parimet etike në vendin e punës?

Sigurisht, nëse punonjësit dinë si të sillen në vendin e punës, parimet etike nuk duhet të formulohen. Edukimi i mirë kulturor

dhe të menduarit janë të mjaftueshëm për të bërë që punonjësit të sillen në mënyrë të favorshme.

Diversiteti në vendin e punës dhe liria e shprehjes e bën të nevojshëm vendosjen e kufijve që nuk duhet të kalohen gjatë sjelljes ndërpersonale dhe kryerjes së detyrave.

Parimet ideale të etikës në vendin e punës duhet të përmbahen në kulturën organizative, por mungesa e saj dhe qasja drejt lirisë së ‘pakushtëzuar’ i bën njerëzit të kalojnë caqet duke krijuar konfuzion.

Parimet e etikës dhe kulturës administrative

Pavarësisht nga kushtet e punës, natyra e punës dhe e fuqisë punëtore, disa parime etike duhet të ndiqen për të rritur harmoninë dhe produktivitetin në vendin e punës, p.sh:

Integriteti: Integriteti personal i punonjësve duhet të jetë i nderuar me çdo kusht. Vlera e integritetit në administratë do të bëjë që të punësuarit të jenë të ndershëm e të drejtë në të gjitha praktikat.

Objektivat: Objektivat duhet të përcaktohen qartë dhe të shfaqen në mënyrë që ato të mbeten në mendje dhe të mund t’i referohemi në çdo kohë. Çdo punonjës duhet të shpjegohet në lidhje me rolin që ai ose ajo ka në arritjen e objektivave.

Përgjegjësia: Çdo individ duhet të jetë i qartë për përgjegjësitë e tij ose të saj. Përgjegjësia duhet të jetë aq e qartë sa kjo nuk duhet të lërë hapësirë për ndonjë paqartësi ose konflikt.

Sinqeriteti: Praktikrat në vendin e punës duhet të lejojnë shkëmbimin e sinqertë dhe të lirë të ideve dhe opinionet në mesin e të punësuarve në të gjitha nivelet. Çdo individ duhet të ketë një rol në gjykimin e mendimit dhe të ideve të nxjerra nga ndonjë punonjës tjetër. (Gjithmonë nëse ka të tillë).

Diversiteti: Çdo administratë duhet të përfshijë në parimet e veta të punës, diversitetin. Asnjë punonjës nga një sfond i ndryshëm kulturor, etnik, fetar apo edukativ nuk duhet të ndjehet i lënë pas dore.

Sjellja: Çdo administratë që ka një grup njerëzish të punësuar duhet të vendosë udhëzime të qarta për sjelljet ndërpersonale.

Kriza jonë kulturore ka të bëjë me kulturën e punës, kemi shumë probleme me këtë, ka një disbalancë mes reales dhe pritshmërisë, prandaj ajo që na duhet, përveç një diplome universitare, e cila tregon formimin tonë akademik si dhe trajnimeve dhe kurseve profesionale me vetë të punësuarit në administratën publike, duhet dhe ajo që më së shumti na mungon, kultura e punës. Në punë të mos shkohet se ‘duhet shkuar’, por sepse duhet të lesh gjurmën tënde të vlerë.

Pra, ajo që duket qartë është që, shumë nga këta njerëz që kërkojnë punë në shtet, nuk duan punë. Duan një pension të sigurt, që pastaj të bëjnë jetën e tyre, midis kafenesë, thashethemeve, “Solitaire”-ve dhe opinionëve profesionale politike. Dhe kur të arrijmë që punën ta kthejmë në art me kulturën tonë akademike dhe profesionale do të kemi arritur standardin që bota europiane do të na pranojë si të barabartë drejt rrugëtimit të ëndrrës qindra vjeçare të shqiptarëve, “E duam Shqipërinë si gjithë Europa!”.

“Shteti është i përbërë nga individët dhe është e nevojshme që virtytet të arrihen nga çdo person, që nga zejtari që duhet të ketë virtytin e urtësisë e deri te drejtuesit që kanë përgjegjësinë që t’i afrohen njohjes të së mirës”.

Për Platonin, shteti ideal ishte aristokracia, ku mbizotëronte arsyeja racionale. Sot nuk e di nëse është realitet apo utopi e ardhur nga “mesjeta e mençur”.

Sfidat e rrugëtimit mes artit të fjalës dhe atij ushtarak

Nexhbedin Basha, ka lindur më 1 janar 1958, në fshatin Shimçan, rrethi Dibër.

Pasi mbaroi shkollën e mesme të përgjithshme “8 Nëntori”, Peshkopi dhe shkollën e mesme pedagogjike “17 Nëntori”, vazhdoi rrugëtimin e tij akademik në Universitetin e Tiranës, dega “Gjuhë Letërsi”, pranë Fakultetit “Histori Filologji”, ku dhe mori titullin “Mësues për gjuhë e letërsi shqipe”, për shkollat e mesme. Por dashuria për uniformën e gjelbër e bëri të mos hezitojë për t’u rreshtuar krah shokëve të tij ushtarak.

Nexhbedini si ushtarak, për ecuri në karrierë e gradë ka kryer kualifikime të veçanta për gradën “major” e “nënkolonel”, si dhe Akademinë Ushtarake “Spiro Moisiu”, Tiranë. Njëkohësisht ka kryer dhe një sërë kualifikimesh të tjera për median, marrëdhëniet me publikun, për gjuhë të huaj anglisht etj.

Prej vitit 1977-1978, ka kryer stazhin e shkollës së mesme në minierën e kromit “Todo Manço”, Bulqizë, ku dhe është aksidentuar.


Në periudhën 1978-1980, ka punuar si arsimtar në fshatrat Zall Kaliz dhe Lugje, Sllove, Radovesh, Ostren, Qafë Murr e Kacni, Selisht, Dibër.

Nga viti 1983 deri maj 1994, ka shërbyer si ushtarak në strukturat e Divizionit Peshkopi. Në vitin 1994, pas pjesëmarrjes në një konkurs të organizuar nga Ministria e Mbrojtjes, fitoi të drejtën për të punuar si gazetar në Shtypin Ushtarak, gazeta “Ushtria” dhe revista “Mbrojtja”, ku punoi deri në prill të vitit 2003. Më pas e emëruan në detyra të tjera në strukturat e Forcave të Armatosura, si: shef i Drejtimit të Brendshëm, shef i Marrëdhënieve me Publikun e Informimin në Tiranë dhe kryetar i degës ushtarake në Kavajë.



Në qershor të vitit 2014, ndërpret karrierën ushtarake për shkaqe shëndetësore. Në vitin 2012 prej një periudhe 6-mujore ka marrë pjesë në misionet paqeruajtëse në Herat, Afganistan, si pjesëtar i FA-së shqiptare në kuadër të NATO-s. Nexhbedin Basha, është autor i tre librave me poezi, njëri i botuar i titulluar “Violina e luleve” dhe dy të tjerët në proces botimi, si “Hija e vetes” dhe “Ujëvarë dashurie”. Gjithashtu është edhe autor qindra shkrimesh të gjinive të ndryshme publicistike, të botuara në gazetën “Ushtria”, revistën “Mbrojtja”, gazeta “Ushtima e maleve” dhe organe të tjera të shtypit publik e privat dhe është vlerësuar nga Ministria e Mbrojtjes me “Certifikatë Mirënjohjeje”, për kontribut të veçantë në organet e shtypit ushtarak. Ai është aktiv dhe botues në rrjetet sociale, portale, unionet poetike me shkrime dhe poezi dhe si poet është vlerësuar me çmime të veçanta. Ka titullin “Ambasador për paqen”, akorduar nga Federata Universale për paqen. Krijimtaria e tij poetike ka natyrë sociale, trajton çështje të humanizmit, të paqes sociale çështje kombëtare etj.

Nexhbedini në rrugëtimin e tij të jetës, si intelektual, gazetar, poet, familjar, ushtarak dhe mësues, konsiderohet një kontributor i paqes.



kuvendojnë,
Nën perin e Marigosë qëndisur flamuri i përflakur.

Ej...rrugicat me emrat e tyre s’janë vetëm emra,
Ata janë memorie e historisë gdhendur,
Si preludi i së nesërme ato lexohen,
Dhe si një kujtesë në shtigje të pa shkelur.

Ej...Nëntorët vikasin, ruani amanetin,
Se prushi e dielli djegin dhe në suferinë,
Nektarin e stinëve për nëntorin e mbledhin...
Lulet e majit, kantatë për përjetësinë....

ME RASTIN E 80-VJETORIT TË ÇLIRIMIT TË ATDHEUT, 112-VJETORIT TË PAVARËSISË DHE KRIJIMIT TË USHTRISË SONË KOMBËTARE

Amanet flamurin

O flamur dritë, o flamur shkabë,
Ti valëvitesh në liri...

Kombi shqiptar akoma i ndarë,
Nëntorët përflakur kuq e zi.

N’shqipen mëmë një rreze drite,
N’shekullin e 21-të kurohet një amanet,
N’kuvend burrat e kombit tubuar,
Me lidh besën për mëmëdhenë.

O flamur i bekuar nga Zoti,
Ti për ne je nënë e babë,
Si shqiponja n’fluturim,
Je rreze drite që skuq flakë.

Në çdo prag pikon gjak Arbëri,
Rrënjë të thella historia,
Shpata, pushka, pena shkruar,
Është e madhe shqiptaria.

Vargje pa fund shkruan poeti,

Si xhevahir i hedh n’ditar,
Në liri mijëra të rënë,
Si heronj mbetën pishtar.

Hej, sa borxh t’kemi o Skënderbe,
Si Kryetrim n’Krujë ngrite flamurin,
Nën gremzat osmane princat bashkove,
Si dengu i thuprave që nuk thyhen.

Ismail Beu cep më cep i ra botës,
Shqipërinë firmësoi, si vatan,
N’Vlorë n’vjeshtën e tretë flamurin ngriti,
Me gaz e lot shpall Pavarësinë dhuratë.

O flamur, o balli i kombit,
N’troje shqiptare valëvitesh krenar,
Je flakadan që s’shuhesh,
Si Dielli që ngroh çdo bajrak.

Mbi truallin e Arbrit fluturon shqiponja,
Si plis i bardhë ti hallemadhe,
Je gur i çmuar në gji të ruajtën të parët,
Si drita e lirisë xixëllon në male.

Të parët mbollën pemën e lirisë,
Ndër shekuj luftuan si dragonj,
Si ilirjan lanë gjurmë në histori,
Flamurin e Skënderbeut lanë, si etalon..

Si diamant, Hymni Kombëtar i Asdrenit,
Me gjak Dëshmorët e të rënë lirinë lanë amanet,
Heshtin dhe zogjtë e malit kur këndohet,
E ne marrim forcë si Prometeu për jetë.

Nëntorët e lirisë vikasin!

Ej...vargje e vargje për Nëntorët kuruar
Ku shpata e pushka rrinë për karshi,
Si shkreptimë pena ndezi lirinë e praruar,
Si etalon ruhet Flamuri dy shkabë, në dritë e errësirë.

Ej, Nëntorët rrëzëllejnë nga e kuja që gjak pikon,
Si një dron fluturon shqiponja mbi tokën e Arbrit,
Në lisin e moçëm të gjakut burrat e kombit



“Starship” i “SpaceX” mund të transportojë njerëz në udhëtime me shpejtësi të lartë rreth Tokës

Duket sikur “SpaceX” po ringjall planet për të marrë përsipër industrinë e aviacionit komercial, duke transportuar pasagjerë në vende të tjera përmes hapësirës.

Pronari miliarder Elon Musk thotë se vizioni i tij ambicioz i udhëtimit hapësinor “Toka në Tokë” me raketën e tij “Starship” është “tani i mundur” pas rizgjedhjes së Donald Trump.

I promovuar për herë të parë nga “SpaceX” pothuajse një dekadë më parë, deri në 1000 pasagjerë do të futeshin në “Starship” - raketa më e fuqishme në Tokë - dhe do të depërtojnë në orbitë.

Por në vend që të zhytej në humnerën e errët të hapësirës, “Starship” do të fluturonte “paralelisht” me Tokën ndërsa përshkon sipërfaqen e planetit, duke u nisur drejt një vendi tjetër.

Elon Musk pretendon se do të shkurtonte në mënyrë dramatike kohëzgjatjen e udhëtimit ajror, duke kursyer kohë si për biznesmenët ashtu edhe për pushuesit, megjithëse ka të ngjarë që ata të paguajnë mijëra dollarë për udhëtim.

“Starship” mund t’i çojë njerëzit nga Londra në Nju Jork në 30 minuta, Nju Jorku në Shangai në 39 minuta dhe Cyrihu në Sydney në 50 minuta, thotë “SpaceX”.

Megjithatë, pasagjerët do të përballeshin me forcat G gjatë ngritjes dhe uljes, ndërsa kushtet e gravitetit të ulët në mes të fluturimit do të nënkuptonin se ata do të duhej të mbanin rripat e sigurimit të shtrënguar.

Udhëtarët gjithashtu mund të këshillohen të mbajnë sediljen e tyre të anuar mbrapa gjatë nisjes dhe “të mbahen fort” ndërsa largohen dhe rihyjnë në atmosferën e Tokës.

Një përdorues i “X” postoi videon promovuese të “SpaceX” në “X” (Twitter), duke sugjeruar se sipërmarrja mund të pastrohet nga Administrata Federale e Aviacionit (FAA) gjatë presidencës së Trump.

Përdoruesi tha: “Nën FAA të Trump, “SpaceX” mund të miratojë “Starship Earth to Earth” brenda pak vitesh, duke i çuar njerëzit nga një qytet në çdo qytet tjetër në Tokë në më pak se një orë.

Musk, një përdorues i zjarrtë i “X”, që i pëlqen t’i mbajë njerëzit të informuar për kompanitë e tij, u përgjigj thjesht për të thënë: “Kjo tani është e mundur”.

Fatkeqësisht, multimiliarderi, i cili derdhi 130 milionë dollarë (102 milionë £) për të mbështetur përpjekjet e fushatës së Trump, raporton CNBC – nuk dha më shumë detaje se kur mund të realizohej projekti.

Videoja e firmës, e publikuar fillimisht në vitin 2017, përshkruan një të ardhme të afërt, ku një tufë njerëzish hipin në një varkë në lumin Hudson në Nju Jork në orën 6:30 të mëngjesit.

Varka më pas transporton pasagjerët e saj në një raketë “Starship” disa milje larg bregut, e cila më pas nis pa probleme në orbitë në orën 7 të mëngjesit.

Me një shpejtësi maksimale prej 27,000 km/h, “Starship” zmadhon planetin në Shangai në Kinë në vetëm 39 minuta.

Në një distancë prej 7,392 miljesh (11,897 km), nga Nju Jorku në Shangai me një aeroplan komercial sot zgjat rreth 15 orë.

Videoja përfundon me anijen prej çeliku-inox, 120 m, duke bërë një ulje të përsosur në një tjetër platformë uljeje në Shangai.

“SpaceX” reklamon shumicën e udhëtimeve në distanca të gjata në më pak se 30 minuta dhe kudo në Tokë në më pak se një orë.

Edhe pse videoja përshkruan një udhëtim pa gabime nga jashtë, asgjë nuk zbulohet se si mund të jenë kushtet gjatë fluturimit për pasagjerët.

Për shkak të gravitetit të ulët në orbitë, pasagjerët do të duhet të jenë të lidhur në sediljet e tyre dhe mund të mos jenë në gjendje të shkojnë në tualet.

Musk ka thënë më parë se “nuk do të nevojiten tualete, zona pilotësh apo galerë ushqimore”, sepse “shumica e fluturimeve do të zgjasin vetëm 15 deri në 20 minuta”.

Si rezultat, pasagjerëve mund t’u duhet të bëjnë një pushim taktik të tualetit në varkë, për t’i shpëtuar ata nga lagështimi në hapësirë.

Fokusi kryesor i “Starship” është sigurisht transportimi i njerëzve më larg - domethënë hëna dhe përfundimisht edhe planetët e tjerë.

Ai do të zbarkojë katër astronautë në Hënë si pjesë e misionit “Artemis 3” të NASA-s, në vitin 2026, udhëtimi i parë me njerëz në sipërfaqen hënore që nga viti 1972.

Musk kohët e fundit tha se “SpaceX” do të dërgojë raketën e saj miliard dollarësh “Starship”, në Mars në vitin 2026, megjithëse do të jetë një mision pa ekuipazh.

Dy vjet pas kësaj, në vitin 2028, “Starship” do të transportojë njerëz në Mars për herë të parë, që do të shënonte herën e parë që njerëzit kanë ecur ndonjëherë në një planet tjetër.

Megjithatë, “Starship” ka pasur teste të lëshimit shpërthyes në dy vitet e fundit dhe sapo ka zotëruar të ngrihet në hapësirë dhe të zbresë në një pjesë.

Muajin e kaluar, “SpaceX” përfundoi ndoshta arritjen e tij më

mbresëlënëse deri më tani, ai arriti të kapte seksionin “përforcues” të sistemit “Starship” me “shkopinj” metalikë në mënyrë që të mund të ripërdorej.

Në një postim ngazëllues në “X”, Elon Musk shkroi: “Kulla e ka kapur raketën!!”, ndërsa zëdhënësja e “SpaceX”, Kate Tice e quajti atë “një ditë për librat e historisë inxhinierike”.

Statistikat e SpaceX Starship

Nisja e parë e suksesshme: Mars 2024?

Për çfarë do të përdoret? Pjesërisht tokëzuesi për misionet e NASA-s në Hënë, por edhe për transportin e njerëzve në Mars

Lartësia: 120m

Pesha: 5 milion kg

Shtytje: 70 Meganewton

A është i ripërdorshëm? po

Ngarkesa maksimale në orbitën e ulët të Tokës: 100-150 tonë

Ngarkesa maksimale në orbitën hënore: 100 tonë

Karburanti i ngurtë: N/A

Karburanti i lëngshëm: Oksigjen dhe metan

Motorët: Mundësuar nga rreth 32 motorë “Raptor”

Moduli i ekuipazhit: “Starship” (në fund të fundit në gjendje të mbajë deri në 100 pasagjerë)

Kostoja e projektit: 3 miliardë dollarë (2.4 miliardë £)

Çmimi për nisje: Në fund të fundit rreth 2 milionë dollarë (1.7 milionë), sipas Musk

Nga do të nisë? Me gjasë objekti “Starbase” pranë Boca Chica, Teksas. Por ndoshta “Launch Complex 39A” në Qendrën Hapësinore “Kennedy”.



Sekretari i Përgjithshëm i drejtohet Simpoziumit të Qëndrueshmërisë së NATO-s 2024



Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Mark Rutte nisi Simpoziumin e Rezistencës së NATO-s 2024 në Bratislavë, Sllovaki.

Në fjalimin e tij me video, zoti Rutte theksoi përparimin thelbësor që NATO dhe aleatët individualë kanë bërë që nga viti 2014 për të forcuar qëndrueshmërinë, një detyrë gjithnjë e më e rëndësishme, pasi shoqëritë në të gjithë NATO-n përballen me sfida në rritje, qoftë nga katastrofat e lidhura me klimën apo aktivitetet keqdashëse kibernetike. Në një kontekst të NATO-s, elasticiteti është aftësia për t'u përgatitur, për t'u rezistuar, për t'u përgjigjur dhe për t'u rikuperuar shpejt nga goditjet ose ndërprerjet dhe është një përparësi për aleatët dhe partnerët. Sekretari i Përgjithshëm theksoi se qëndrueshmëria nuk është rreptësisht ushtarake apo civile, por "një përgjegjësi e gjithë qeverisë dhe e gjithë shoqërisë". Kjo është arsyeja pse aleatët vendosën të integrojnë planifikimin civil në planifikimin kombëtar dhe kolektiv të mbrojtjes. Dhe ndërsa ky përparim është i rëndësishëm, z. Rutte pranoi se ka më shumë punë për të bërë, duke theksuar "nevojën për të dyfishuar

ndërtimin e një kulture të përbashkët të elasticitetit në të gjithë Euro-Atlantikun", duke ndërtuar një komunitet të NATO-s që përfshin sektorët publikë dhe privatë, së bashku me organizatat e tjera ndërkombëtare, veçanërisht Bashkimin Evropian. "Së bashku, ne mund t'i rezistojmë më mirë presionit në rritje nga ata që kërkojnë të shfrytëzojnë dobësitë tona", përfundoi Sekretari i Përgjithshëm.

Këtë vit, Simpoziumi u fokusua në promovimin e një qasjeje proaktive civilo-ushtarake ndaj elasticitetit, në mbështetje të planeve të mbrojtjes të NATO-s dhe në përputhje me angazhimet e marra nga Aleatët në Samitin e Uashingtonit 2024.

Duke bashkuar mbi 200 udhëheqës civilë dhe ushtarakë, politikëbërës, praktikues dhe ekspertë nga vendet aleate, partnerë, akademi dhe industri, Simpoziumi vjetor i Qëndrueshmërisë së NATO-s ofron një mundësi për të vlerësuar punën e vazhdueshme dhe për të eksploruar ide për të informuar axhendën e elasticitetit të NATO-s.

Rezistenca, gatishmëria civile dhe Neni 3

Cdo vend anëtar i NATO-s duhet të jetë elastik në mënyrë që t'i rezistojë një tronditjeje të madhe siç është një fatkeqësi natyrore, dështimi i infrastrukturës kritike ose një sulm hibrid ose i armatosur. Rezistenca është kapaciteti individual dhe kolektiv për t'u përgatitur, rezistuar, përgjigjur dhe rikuperuar shpejt nga goditjet dhe ndërprerjet, dhe për të siguruar vazhdimësinë e aktiviteteve të Aleancës. Gatishmëria civile është një shtyllë qendrore e qëndrueshmërisë së aleatëve dhe një mundësi kritike për mbrojtjen kolektive të Aleancës, dhe NATO mbështet aleatët në vlerësimin dhe rritjen e gatishmërisë së tyre civile. E rrënjësor në nenin 3 të Traktatit të Atlantikut të Veriut, qëndrueshmëria kombëtare dhe kolektive janë një bazë thelbësore për parandalimin dhe mbrojtjen e besueshme, dhe për këtë arsye janë jetike për përpjekjet e NATO-s për të mbrojtur shoqëritë, popullsinë dhe vlerat e saj të përbashkëta.

Forcimi i qëndrueshmërisë

Rezistenca në një kontekst të NATO-s i referohet aftësisë për t'u përgatitur, për të rezistuar, për t'u përgjigjur dhe për t'u rikuperuar shpejt nga goditjet dhe ndërprerjet. Forcimi i qëndrueshmërisë është kryesisht një përgjegjësi kombëtare, por përpjekjet e aleatëve individualë gjithashtu e bëjnë Aleancën më të fortë në tërësi. Aleatët mund të rrisin qëndrueshmërinë e tyre përmes zhvillimit të kapaciteteve të tyre të mbrojtjes kombëtare, aksesit të siguruar në infrastrukturën kritike dhe zhvillimit të planeve mbështetëse në rast krizash. Për të penguar, kundërshtuar ose rikuperuar nga kërcënimet ose ndërprerjet në sektorin civil, veprimi efektiv kërkon plane të qarta dhe masa reagimi që përcaktohen para kohe dhe ushtrohen rregullisht.

NATO mbështet aleatët në forcimin e qëndrueshmërisë. Në Samitin e Varshavës 2016, Udhëheqësit Aleatë ranë dakord të rrisin qëndrueshmërinë e NATO-s ndaj spektrit të plotë të kërcënimeve dhe të zhvillojnë më tej kapacitetin individual të vendeve të tyre në lidhje me kapacitetin kolektiv të NATO-s për t'i rezistuar çdo forme sulmi të armatosur. Ata ranë dakord për shtatë kërkesat bazë të mëposhtme për qëndrueshmërinë kombëtare, kundrejt të cilave aleatët mund të masin nivelin e tyre të gatishmërisë:

Sigurimi i vazhdimësisë së qeverisë dhe shërbimeve kritike të qeverisë. Për shembull, aftësia për të marrë vendime dhe për të komunikuar me qytetarët në një krizë; Furnizimet elastike të energjisë: sigurimi i një furnizimi të vazhdueshëm me energji dhe të kesh plane rezervë për të menaxhuar ndërprerjet; Aftësia për t'u përballur në mënyrë efektive me lëvizjen e pakontrolluar të njerëzve dhe për të ç-konfliktuar këto lëvizje nga dislokimet ushtarake të NATO-s; Burimet elastike të ushqimit dhe ujit: sigurimi i furnizimeve elastike që janë të sigurta nga ndërprerja ose sabotimi; Aftësia për t'u marrë me viktima masive dhe kriza shqetësuese shëndetësore: sigurimi që sistemet shëndetësore civile mund të përballojnë dhe se furnizimet e mjaftueshme mjekësore janë të pajisura dhe të sigurta; Sisteme elastike të komunikimeve civile: sigurimi që rrjetet e telekomunikacionit dhe kibernetike mund të funksionojnë edhe në kushte krize, me kapacitet të mjaftueshëm rezervë. Kjo përfshin gjithashtu nevojën për sisteme të besueshme të komunikimit duke përfshirë 5G, opsione të fuqishme për të rivendosur këto sisteme, akses me përparësi tek autoritetet kombëtare në kohë krize dhe vlerësime të plota të të gjitha rreziqeve për sistemet e komunikimit; Sisteme transporti elastike: sigurimi që forcat e NATO-s të mund të lëvizin me shpejtësi nëpër territorin e Aleancës dhe që shërbimet civile të mund të mbështeten në rrjetet e transportit, edhe në një krizë.

Këto Kërkesa Bazë pasqyrojnë tre funksionet thelbësore të gatishmërisë civile, të cilat duhet të mbahen edhe në kushtet më të vështira: vazhdimësia e qeverisjes, shërbimet thelbësore për popullsinë dhe mbështetja civile për ushtrinë. Këto tre funksione thelbësore dhe shtatë kërkesat e linjës bazë janë të gjitha të lidhura, që do të thotë se nëse një zonë preket, një tjetër mund të vuajë si rezultat.



Personeli i Forcave të Armatosura të Luksemburgut ngriti një strukturë mjekësore të lëvizshme në Qendrën "Hospitalier du Nord" në Ettelbruck, Luksemburg gjatë pandemisë COVID-19, e cila testoi qëndrueshmërinë e vendeve të NATO-s.

Si pjesë e axhendës së NATO-s 2030, në vitin 2021 aleatët ranë dakord të miratonin një qasje më të integruar dhe më të koordinuar për forcimin e qëndrueshmërisë. Kjo përfshin formalizimin e objektivave të elasticitetit për të udhëhequr qëllimet e elasticitetit të zhvilluara në nivel kombëtar dhe planet e zbatimit, si dhe caktimin e zyrtarëve të lartë përgjegjës për qëndrueshmërinë për të koordinuar përpjekjet kombëtare dhe për të përmirësuar konsultimet me NATO-n.

Në vitin 2022, NATO krijoi një Komitet të ri të Lartë të Qëndrueshmërisë, i cili përfshinte funksionet dhe rolet e Komitetit të Planifikimit të Emergjencave Civile (CEPC). Komiteti i Qëndrueshmërisë është përgjegjës për dhënien e drejtimit strategjik dhe politik dhe koordinimin e aktiviteteve të NATO-s për elasticitetin. Ky Komitet trajton një sërë çështjesh, duke përfshirë dezinformimin, qëndrueshmërinë kritike të infrastrukturës, ndikimin e ndryshimeve klimatike dhe sigurinë e zinxhirit të furnizimit.

Koncepti Strategjik i vitit 2022 – dokumenti kryesor i politikës së Aleancës – e identifikon qëndrueshmërinë si kritike për detyrat kryesore të NATO-s: parandalimin dhe mbrojtjen, parandalimin dhe menaxhimin e krizave dhe sigurinë bashkëpunuese. Ai gjithashtu thekson se konkurrentët strategjikë testojnë qëndrueshmërinë e NATO-s dhe aleatëve. Në miratimin e Konceptit Strategjik, aleatët ranë dakord të forconin qëndrueshmërinë kombëtare dhe të gjithë Aleancës kundër kërcënimeve dhe sfidave ushtarake dhe joushtarake ndaj sigurisë. Zyrtarët e lartë aleatë përgjegjës për qëndrueshmërinë u takuan për herë të parë në selinë e NATO-s në Bruksel në vitin 2022.

Në Samitin e Vilniusit të vitit 2023, udhëheqësit aleatë përsëritën angazhimin e Aleancës për të forcuar qëndrueshmërinë si një bazë thelbësore për parandalimin dhe mbrojtjen e besueshme. Ata gjithashtu theksuan një numër fushash që do të kërkojnë vëmendje të mëtejshme kolektive dhe individuale, duke përfshirë qëndrueshmërinë shoqërore, sistemet shëndetësore, infrastrukturën kritike dhe zinxhirët e furnizimit.

Në Samitin e Uashingtonit të vitit 2024, aleatët u zotuan të ndërtojnë përpjekjet për të forcuar qëndrueshmërinë kombëtare duke integruar planifikimin civil në planifikimin kombëtar dhe kolektiv të mbrojtjes në paqe, krizë dhe konflikt. Aleatët gjithashtu u angazhuan për të thelluar bashkëpunimin me partnerët që janë të angazhuar në

përpjekje të ngjashme, veçanërisht me Bashkimin Evropian.

Që nga viti 2022, NATO ka organizuar gjithashtu një Simpozium vjetor të Qëndrueshmërisë që mbledh së bashku liderë civilë dhe ushtarakë, politikëbërës dhe ekspertë të industrisë për të shkëmbyer pikëpamje mbi sfidat aktuale dhe për të promovuar mënyra për të ndërtuar elasticitet.

Forcimi i bashkëpunimit civilo-ushtarak

Rezistenca mbështetet në bashkëpunimin e fortë midis palëve të interesuara civile dhe ushtarake, i cili është me përfitim reciprok, si në kohë paqeje ashtu edhe në kohë krize. Siç tregoi pandemia COVID-19, ndihma ushtarake për autoritetet civile mund të jetë një mbështetje kritike kur burimet civile janë nën stres të rëndë. Në të njëjtën kohë, mbështetja civile është thelbësore për të mundësuar dhe mbështetur forcat ushtarake të NATO-s në kohë krize, qoftë nëpërmjet ekspertizës civile ose aksesit në shërbimet dhe infrastrukturën tregtare kritike.

Stërvitjet përfaqësojnë një mënyrë efektive për të kryer teste stresi të gatishmërisë kombëtare, veçanërisht kur bëhet fjalë për raste të paparashikuara në shkallë të gjerë si sulmet me armë të shkatërrimit në masë ose kur kemi të bëjmë me luftë hibride. Mjete të reja vlerësimi po zhvillohen për të përmirësuar mënyrën se si NATO dhe Aleatët identifikojnë dobësitë, vlerësojnë gatishmërinë e tyre dhe përmirësojnë kapacitetin e tyre. Për të testuar përgjigjet e aleatëve ndaj situatave të krizës, elementë të gatishmërisë civile po ndërtohen në stërvitjet ushtarake të NATO-s në të gjitha nivelet, nga ushtrimet e menaxhimit të krizave të nivelit strategjik dhe ushtrimet me dukshmëri të lartë deri tek ushtrimet e nivelit më të ulët komandues dhe në terren. Për shembull, ushtrimet e rregullta të NATO-s për Menaxhimin e Krizave vlerësojnë procedurat e konsultimit dhe vendimmarrjes së Aleancës mbi qëndrueshmërinë në nivelin strategjik politiko-ushtarak.

Angazhimi i vazhdueshëm me organizatat e tjera ndërkombëtare si Bashkimi Evropian (BE) dhe Kombet e Bashkuara (OKB) është çelësi për forcimin e qëndrueshmërisë dhe zhvillimin e ndërgjegjësimit të përbashkët të situatës. BE-ja, në veçanti, mbetet një partner thelbësor për NATO-n nëpërmjet konsultimeve staf me staf dhe bashkëpunimit praktik në një sërë fushash që lidhen me elasticitetin. Që nga viti 2022, NATO është angazhuar me BE-në në një Dialog të Strukturuar mbi Qëndrueshmërinë.

